

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924



The **Albanian**

VITI I 20 I BOTIMIT 25 TETOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**40% E SHITESËS SË MESME GATI PËR
EMIGRIM, NGA MUNGESA E PERSPEKTIVËS
DHE SISTEMIT SHËNDETËSOR**



PETRIT KUÇANA

**DIASPORA,
SI ETJE
E KRYEMINISTRIT
PËR DUATROKITJE**




ARBEN MANAJ

**TRUMP "GODET"
ANGLINË:
AKUZON LABURISTËT
PËR NDËRHYRJE
NË ZGJEDHJE!**


**KUSH PO E KTHEN
MAQEDONINË E VERIUT
PARA MARRËVESHJES
SË OHRIT?**

EMIN AZEMI




**ÇFARË I DUHET
SHQIPËRISË SOT!**

DITMIR BUSHATI



**SPAK-U PO BËN ÇDO GJË
PËR TË MBROJTUR
PRONARIN E SHQIPËRISË,
EDI RAMËN**

KIM MEHMETI




**ROBESPIERRISTËT E
VEGJËL MES NESH**

GENC POLLO



**BULETINI I KUQ I
RADIO KISHNJEVIT**

VETON SURROI



**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

'Mërgata është pjesë e pandashme e kombit tonë, andaj ju ftoj që të regjistroheni secili dhe secila prej jush!'

Kështu thotë kryeministri i Kosovës në një nga prononcimet e tij, ku i bëhet thirrje diasporës për tu regjistruar. 'Procesi i regjistrimit si qytetarë jo rezident të Republikës së Kosovës është mundësia juaj për të forcuar lidhjen me atdheun.

DIASPORA, SI ETJE E KRYEMINISTRIT PËR DUARTROKITJE

Regjistrimi është i shpejtë dhe i lehtë, por me ndikim të madh. Të dhënat tuaja do të ndihmojnë në krijimin e politikave që mbështesin mërgatën, përmirësojnë shërbimet, si dhe forcojnë lidhjet kulturore dhe arsimore me atdheun.' Thuhet ndër të tjera në thirrjen e Albin Kurtit. Do të ngjante tejet e pabesueshme nëse një thirrje të tillë ta kishim edhe nga kryeministri i Shqipërisë, por prej 12 vitesh në pushtet, nuk kemi parë ndonjë përçapje të angazhimit të tij, apo të qeverisë që ai drejton drejt diasporës shqiptare.

Nëse i referohemi ish-ministrit të Diasporës Pandeli Majko i bie që të paktën gjysma e popullsisë së republikës jeton jashtë. Nuk është shumë larg mendsh të kuptohet që kalkulimet politike nuk lejojnë 'shkitjen' në të panjohurën me diasporën. E prandaj duket që prej mëse një dekade nuk e

vunë ujin në zjarr së paku për regjistrimin e diasporës.

As që u ka shkuar ndërmend që të ndjekë shembullin e Prishtinës (sistemi i patronazhimit nuk aplikohet atje, e mbase nuk mund të imagjinohet një gjë e tillë).

Shumëkujt u kujtohet ato të ashtuquajtura samitet e famshme të diasporës që u bënë në Tiranë. Askush, (qoftë edhe patronazhistët apo ithtarët e flaktë) nuk mund të kujtojnë një adresim, arritje, punë të kryer që u bë. Madje një ministri shteti për Diasporën (lexo ministër pa portofol), u konsiderua më shumë si një punësim i Majkos sesa vëmendje ndaj diasporës.

Ngjasojnë tepër qeshakake shifrat që ofrojnë zyrtarët për regjistrimin e diasporës. Diku 17 000 shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë janë regjistruar në 12 vjet. Çdo shqiptar do

të mendonte se kjo shifër është vetëm në lagjen e tyre ku banojnë, jo më në shtetin apo kontinentin e tyre. Mbase do të ngjante tejet cinike, të vazhdonim krahasimin me Prishtinën kur 'përtej Drinit' ditët e diasporës janë tashmë një rutinë e ripërsëritur, dhe në çdo qytet në verë diaspora është kryefjala e çdo festimi. Po si nuk u oprganizua qoftë edhe një aktivitet në Shqipërinë amë për diasporën? Deri më sot kujtohen ca fjalime të Ramës në Athinë dhe Milano dhe anullimi i Londrës. Askush nuk e di sa kushtuan fjalimet dhe se pse realisht u anulua Londra. Transparenca duket se është gjëja e fundit që u shkon ndërmend qeveritarëve dhe se i gjithë fokusi ishte tek salla, mbushja e sallës, duartrokitjet frenetike të militantëve, qoftë edhe të importuarve nga mëmdeheu si patronazhistë të paepur... Ato nuk konsiderohen

takimi pasi Rama nuk u takua me emigrantët, përfaqësuesit e tyre, përfaqësuesit e grupeve të tyre të interesit, me doktorët e shkencave, apo qoftë edhe biznesmenët. Jo ai thjesht lexoi një fjalim të gjatë dhe kaq. Çfarë u arrit nga këta fjalime? A ishte vërtet etja për duartrokitje e kryeministrit që sfidon çdo logjikë ekonomike dhe jo vetëm...?

A mund ta lexonte kryeministri atë fjalim dhe ta postonte në rrjetet sociale dhe me paratë e shpenzuara për organizmin e tyre, të kontribonte bie fjala në regjistrim e diasporës, apo në shërbimet konsullore që në shumë shtete të lënë për të dëshiruar?

Apo në ngritjen e qëndrave kulturore? Apo në kushedi sa e sa projekte të tjera për diasporën. Por duket se këto nuk i sjellin sadsifaksion një kryeministri që ka mbi një dekadë në pushtet. E as diaspora në vetvete nuk duket t'i ketë sjellë ndonjë ndjesi, që ta nxiste të kujtohej se të paktën duhej hedhur një sy nga Prishtina, për të mësuar sesi të bashkëpunojë me diasporën. ribotim

 Discover The Latest Trends in Technology

Dotech

website 

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore,
ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë
çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel: 0208 090 2488 info@lexmarklegal.com

Një sondazh i "Monitor", që nisi më 11 shtator të këtij viti dhe zgjati rreth një muaj, ku u intervistuan 1044 persona rreth arsyeve që çojnë individët dhe familjet të largohen nga Shqipëria,

Nga 1044 të anketuar, 187 persona ose rreth 18%, tashmë ishin larguar nga Shqipëria. 34% e tyre ishin 20-29 vjeç kur ishin larguar nga vendi, 30.5% ishin ndërmjet 30 dhe 39 vjeç dhe 13% ndërmjet 40-49 vjeç. Mbi 44% e tyre kishin më shumë se pesë ose më shumë vite që kishin emigruar dhe pjesa tjetër, 45%, kishin një deri në tre vite në emigracion dhe 10% kishin më pak se një vit.

Shumica e tyre, rreth 72%, dhanë si arsye kryesore për largimin nga vendi "Korrupsionin e lartë dhe mosfunksionimin e institucioneve", një pjesë e madhe mbi 40% renditën si arsye për largimin, mungesën e mundësive për zhvillim profesional, problemet shëndetësorë dhe mungesën e shërbimeve cilësore. Për rreth 40% të të larguarve, cilësia e dobët e arsimit, mungesa e stabilitetit politik dhe pagat e

TË IKURIT, DOMINOJNË TË RINJTË, KORRUPSIONI SI ARSYE MADHORE

ulëta ishin një nga tre arsyet themelore për mbi 30% të të larguarve.

Një qytetar komentoi "Ka shumë korrupsion, politika jo të qarta, zero transparencë dhe zero konkurrencë e ndershme. Pyetja është a ikin shqiptarët nga Shqipëria apo nga vetë shqiptarët? Mund të kesh para mjaftueshëm, por nëse je i detyruar ta marrësh shërbimin larg banesës dhe me korrupsion, paratë nuk vlejnë".

"Unë personalisht ika për fëmijët. Nuk shikoja të ardhme për ta në Shqipëri", tha një qytetare tjetër. 44% e të larguarve pohuan se ishin shumë të pakënaqur me situatën ekonomike në Shqipëri dhe vetëm 7% ishin shumë të kënaqur, por kishin ikur për arsye të tjera. 69% e të ikurve vlerësuan si shumë të rëndësishme mundësitë e punësimit jashtë vendit për vendimin emigrimit, ndërsa 24.6% i vlerësuan disi të rëndësishme dhe vetëm 3.2% thanë se mundësitë e punësimit jashtë vendit nuk ishin aspak të rëndësishme

për vendimin e largimit.

40% e larguarve pohuan se kishin një arsye familjare për të emigruar.

Rreth 45% e të larguarve ndihen të integruar tërësisht në shoqëritë ku jetojnë dhe 44% ndihen disi të integruar, ndërsa 7% pohuan se nuk janë integruar.

58% e të larguarve po marrin e dhe familjarët

Fenomeni i emigrimit ka marrë formën e një spiraleje. Shumë prej atyre që kanë ikur po marrin edhe familjarët e tjerë që jetojnë në Shqipëri, duke dhënë tek ata shembullin e një jete më të mirë. 58% e të anketuarve që ishin larguar nga Shqipëria pohuan se do të merrnin edhe familjarët e tyre, 23% thanë se nuk kishin plane të tilla dhe 18.7% nuk ishin të sigurt.

Nëse është një gjë që shqiptarët e kanë mësuar mirë, është emigracioni. Përvojat e shumta të të ikurve janë kthyer në magnet për

ata që jetojnë në Shqipëri, duke nxitur edhe më tej presionin për largim të atyre që jetojnë në Shqipëri.

57% e të ikurve nuk kanë në plan të kthehen

Shumica e emigrantëve të larguar nuk kanë në plan të kthehen në Shqipëri.

Pyetjes "A keni menduar ndonjëherë të ktheheni në vend pas një periudhe jete jashtë", 57% ju përgjigjën negativisht. 24% pohuan se nuk do të kthehen dhe 33% pohuan se mund të vijnë vetëm për pushime. 17% nuk ishin të sigurt, ndërsa 23% kishin planifikuar kthimin pas disa vitesh. 96% e të anketuarve mendojnë se emigracioni e ndikon negativisht vendin.

Pjesa më e madhe e të larguarve, 72%, do të ktheheshin nëse përmirësohej sistemi shëndetësor dhe mbrojtja sociale.

Një pjesë e madhe, më shumë se gjysma, konsiderojnë si mundësi

për rikthim përmirësime në infrastrukturë dhe kushtet e jetesës, mundësi punësimi, paga më të larta, stabilitetin dhe sigurinë, si dhe arsimin.

"E vetmja zgjidhje në këtë situatë që ndodhen institucionet në vendin tonë është ndryshime radikale në funksionimin e strukturave shtetërore, pavarësia e tyre, por edhe zvogëlimi i administratës tepër të fryrë përmes mbajtjes në punë vetëm të personave të paaftë. Shkollat në Shqipëri nuk plotësojnë kërkesat bazë për prindërit, p.sh. orari i mësimit nuk zgjat sa puna dhe cilësia është e dobët.

Shkollat private paguhen sa jashtë, ndërkohë nuk kanë as fusha për fizikulturë. Gjithçka për fëmijët kushton më shumë.

Shqipëria nuk bëhet as për fëmijët e mi, kështu që nuk kam ndërmend të sakrifikoj jetën e tyre për një palo vend si Shqipëria", – tha një komentuese në përgjigje të pyetjes "A do ta konsideronit kthimin në vend, nëse do të kishte përmirësime në këto fusha? MONITOR

Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund te vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

MY **UK**
Law ✓

Kërkoni ndihmë ligjore në
gjuhën shqipe?

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA

MY **UK**
Visas ✓

VISAS ✓

PROPERTY ✓

FAMILY ✓

BUSINESS ✓

NEGLIGENCE ✓

EMPLOYMENT ✓

MyUKLaw është një studio ligjore e drejtuar nga Avokatja shqiptare Arta Heath, e cila ka mbi 23 vite përvojë pune në Angli dhe 14 vite e licencuar nga Autoriteti i Rregullimit të Avokatëve (SRA) në Angli. Studioja ka zyrë në Londër, Sheffield, Huddersfield si dhe një zyrë lidhëse në Tiranë.

Për këshilla në gjuhën shqipe dhe përfaqësim nga juristë me njohuri të ligjeve angleze dhe shqiptare në fushat e sipërme, mund të na kontaktoni.

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30

<u>Huddersfield</u>	<u>Sheffield</u>	<u>London</u>	<u>Tirana</u>
Besmir Mujo	Klodiana Gjonaj	Daniel Buna	Dorotea Celaj
+44 (0) 7861 391147	+44 (0) 7454 819683	+44 (0) 7832 599757	+355 69 659 8957



Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 21:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



reviewsolicitors
TRUSTED LAW FIRM

"EXCELLENT"
4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS

**Ranked
TOP 10%
2024**

**Solicitors
Regulation
Authority**

ARBEN MANAJ

ANGLIA, SANKSIONE IZRAELIT/ KRYEMINISTRI STARMER: DEKLARATAT E ZYRTARËVE TË LARTË JANË TË TMERRSHME

Kanë qenë komentet e bëra nga Ministri izraelit i Financave, Smotrich dhe Ministri i Sigurisë Kombëtare Ben-Gvir, ku i pari deklaronte se vuajtjet e civileve në Gaza mund të jenë të justifikueshme apo ministrit tjetër se atë që kryen dhunë në radhët e izraelitëve të vendosur në Bregun Perëndimor ishin heronj, ç'ka e kanë detyruar kryeministrin britanik Sir Keir Starmer të deklarojë se Londra po shqyrton mundësinë e vendosjes së sanksioneve ndaj këtyre zyrtarëve të lartë në Tel-Aviv.

“Ne po e shqyrtojmë këtë mundësi sepse këto komente janë qartazi të tmerrshme”, ka deklaruar kryeministri Starmer.

Ndërkohë këta ministra në kundërpërgjigje thonë se këto sanksione nuk do çojnë në ndryshimin e qëndrimeve të tyre. Por mundësia e sanksioneve ndaj zyrtarëve të lartë izraelitë duket

se ka qenë opsion edhe i ish-ministrit të Jashtëm konservator David Cameron.

Deklarata e Sir Keir Starmer merr një rëndësi të posaçme pasi bëhet në prag të një takimi urgjent në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të diskutuar për situatën humanitare në Gaza e thirrur në fakt nga Britania, Franca dhe Algjeria.

Starmer deklaroi në Parlamentin Britanik se situata humanitare në Gaza është e rëndë. Edhe pse Britania historikisht është një mbështetëse e Izraelit dhe ka kontributin e saj unik në krijimin e shtetit të Izraelit, ajo e ka mbështetur Tel Avinin në të drejtën e saj për t'u vetëmbrojtur dhe ka ndihmuar ushtarakisht në eliminimin e efektivitetit të sulmeve ajrore me raketa baleslike dhe drone nga Irani ndaj Izraelit.



Britania ka vendosur gjithsesi sanksione për licencat për shitjet e disa armëve britanike ushtrisë izraelite. Por qeveria e re laburiste e qendrës së majtë, ku të majtët janë më pranë çështjes palestineze sesa konservatorët, Sir Keir Starmer ka mbajtur një

qëndrim disi më të ashpër ndaj Izraelit pas ardhjes në pushtet.

Dukshëm qëndrimet e disa zyrtarëve të lartë izraelit e kanë çuar durimin dhe parimësinë ndaj disa vijave të kuqe deri në provokim ndaj Britanisë apo demokracisë

të përparuar perëndimore janë të detyruara të reagojnë, por deri ku dhe sa efektiv do jetë reagimi mbetet për t'u parë, pa ndonjë shpresë për ndryshim radikal në mbështetjen ndaj Izraelit, për shkak të interesave më të gjëra gjeostrategjike në rajon. tch



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



For Sale

For Sale

PËR SHITJE

Ne nje nga zonat me te frekuentuara ne veri te Londres

I hapur prej 20 vitesh

Me klientele te garantuar perballe nje shkolle

Çmimi shumë i arsyeshëm

Mundesesi fantastike per zhvillimin e biznesit

Për më shumë info tel:
07832 112964



For Sale



For Sale



For Sale



ARBEN MANAJ

Ajo c'ka pretendon ekipi i fushatës së Donald Trump është se anëtarë të Partisë Laburiste vullnetarisht bashke me disa raportime për kontakte mes perfaqësuesve të lartë të Laburisteve britanik, kanë bërë që të ketë ndërhyrje të paligjshme të huaj në fushatën zgjedhore në Shtetet e Bashkuara.

Ndërkohë kryeministri britanik Sir Keir Starmer e zbuti polemikën duke thënë se anëtarët kishin shkuar në Amerikë si vullnetarë dhe jo zyrtarisht të dërguar nga partia e tij. Në fakt, që laburistët ndihmojnë demokratët si dy parti te majta, kjo

Media prestigjioze britanike BBC ia ka dedikuar një artikull brandave kriminale shqiptare që kontrabandojnë njerëz në Britaninë e Madhe dhe i detyrojnë të punojnë në fermat e kanabisit.

Sipas BBC, këto banda po goditen nga policia britanike dhe se policia e Mançesterit ka arrestuar 46 shtetas shqiptarë në vitin 2023 dhe zbuloi më shumë se 10 milionë paund kanabis.

Policia e Mançesterit të Madh (GMP) tha se njerëzit ishin të detyruar të punonin në kushte të tmerrshme, ndërsa bosët e tyre kriminalë bënin pasuri të konsiderueshme. Det Supt Joe Harrop tha se grupet nga Ballkani Perëndimor ishin fokusi i një operacioni që përfshinte forca policore nga e gjithë Mbretëria e Bashkuar.

“Shpesh, bandat shqiptare kanë blerë

Thomas Tuchel, do jetë trajneri i ri i Anglisë në futboll, pas tentativës së dështuar me Pep Guardiola deri dje.

Ai do jetë i treti trajner i huaj në krye të pankinës angleze pas suedezit të ndërës, Sven Joran Erikson dhe italianit Fabio Kapelo. 51 vjecari Tuchel, do jetë i pari gjerman që drejton Anglinë, por ai njihet si ish-trajneri i Chelsit të Londrës me të cilët fitoj Champions League dhe se fundmi ish-trajneri i Bayern Munchen.

TRUMP “GODET” ANGLINË: AKUZON LABURISTËT PËR NDËRHYRJE NË ZGJEDHJE!

nuk është e re, pasi ka dekada që kjo ndodh, si për t'u dhënë një dorë në cdo palë zgjedhesh, ashtu edhe për të marrë ndonjë sugjerim elektoral. Po ashtu edhe mes konservatoreve të djathtë britanik dhe Republikanëve amerikane ndodh e njëjta gjë. Babai i Brexit, Nigel Farage, akoma më i djathtë, ka shkuar dhe është sërish pranë edhe në këtë fushatë me Donald Trump.

Ndërkohë kur ish-kandidati për president Xhorxh E. Bush kërkoj nga sivëllezërit e tij britanik, dhe ish-kryeministri John Major që te gërmonte në të shkuarën is student ne Britani, të rivalit të tij



Bill Clinton, marredhëniet e këtij të fundit që fitojë zgjedhjet nuk ishin të mira me Kryeministrin konservator Xhon Mejxher. Andaj dhe gjasat

janë që edhe sikur Donald Trump do bindet se nuk është zyrtarë ky vullnetarizëm nga disa anëtarë të Laburistëve, kjo nuk do i bëjë më të lehta marrëdhëniet mes Uashingtonit dhe Londrës, po të fitoj Trump.

Kjo është edhe frika në shumë kryeqytete evropiane për një fitore të mundshme të Trumpit, dhe rreziku eventual i ftohjes së marrëdhënies mes dy anëve të Atlantikut, sic u pa edhe në mandatin e parë të Trumpit, në raportet me aleatët perëndimor të Amerikës. Fakti që anketa bëhet publike, flet shumë, dhe paralajmëron, po aq shumë, për skenarët e mundshëm diplomatik dhe politik nga rokada e mundshme në Shtëpinë e Bardhë.topchannel

BBC: SI PO I GODET POLICIA BRITANIKE BANDAT SHQIPTARE QË KONTRABANDOJNË NJERËZ DHE I DETYROJNË TË PUNOJNË NË FERMAT E KANABISIT NË BRITANI?

njerëz për të punuar në Mbretërinë e Bashkuar në vende si fermat e kanabisit. Këto janë kushte të tmerrshme. Ata jetojnë dhe flenë brenda fermave dhe nuk mund të largohen.

Ata mirëmbajnë bimët të cilat shpesh janë në faza të ndryshme të rritjes në dhoma të ndryshme. kokat e larta të këtyre grupeve të kriminit fitojnë një sasi të madhe parash“, tha Det Supt Harrop. Ai tha se grupet do të blejnë “makina luksoze” dhe rroba dhe ora të markave të shtrenjta, dhe më pas do të kthehen në vendin e tyre dhe “të

lavdërojnë atë pasuri“, gjë që inkurajon “një brez tjetër kriminelësh të vijnë në Mbretërinë e Bashkuar”.

Sekuestrimet

Si pjesë e një hetimi midis majit dhe nëntorit 2023, oficerët morën dëgjime për një shqiptar që besohet se po kontrollonte të tjerët në prodhimin në shkallë të gjerë të kanabisit në të gjithë rajonin.

Duke identifikuar anëtarët e nivelit më të lartë të bandës, policia ishte në

gjendje të bënte disa arrestime midis rrjetit, thanë ata.

Në vitin 2022, policia bëri 10,788 sekuestrime kanabis, dhe në vitin pasardhës kjo shifër u rrit në 13,247.

Në shtator 2024, katër persona nga Shqipëria morën dënime të gjata me burg për operimin e fabrikave të kanabisit.

Shifrat e Ministrisë së Drejtësisë tregojnë se, në fund të marsit 2024, më shumë se 1200 shqiptarë mbaheshin në burgjet në Angli dhe Uells, më shumë se çdo kombësi tjetër e huaj.

Amy Bond, shefi operativ i shoqatës bamirëse të skllavërisë moderne Causeway, tha: “Shumica e njerëzve të bllokuar në skllavërinë moderne janë të bllokuar në shfrytëzimin e punës, kështu që janë gjëra të tilla si fermat e kanabisit.

Ka pasur një kalim nga bandat vietnameze në ato shqiptare. Bandat do të sjellin njerëz në këto mjedise dhe do t'u premtojnë atyre një punë. Viktimat më pas përfshihen në punë të paligjshme dhe nuk mund të largohen sepse kanë frikë nga ndjekja e tyre”.

ANGLIA ME TRAJNER TË RI, ZGJIDHET GJERMANI THOMAS TUCHEL!

studimet për menaxhim biznesi dhe punonte si kamarier kur ishte student. Menaxhimin e futbollit e filloj me ekipet e moshës së Shtutagrtit, dhe me pas me ekpin e Mainz, duke pasuar Jurgen Klopp e Liverpoolit, e me pas Borussia Dortmund, serish pas Klopit.

Në 2018 ai merr drejtimin e PSG, duke

e cuar në finalen e Champions League. Ndërkohë në Londër vjen për të drejtuar Chelsin në 2021 duke fituar Champions League me Manchester City 1-0 në finale. Rikthehet në Munich me Bayernin ku merr me vete sulmuesin kryesor të Anglisë, Harry Kane. Ardhja e Thomas Tuchel, në krye të Kombëtares angleze mund të jetë një ofendim për puritanët

nacionalist anglez, të cilët e shohin emërimin e tij si një sakrificë parimore në kurriz të një zgjidhje të shpejtë në kohë për Kupën e Botës në 2026.

Nëse Anglia fiton Kupën e Botës do jetë hera e dyte pas fitores me Gjermaninë në 1966, nga ku është me origjinë trajneri i ri i anglezëve.



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



Business Cards 

Banners 

Posters 

Flyers 

Video Marketing 

Adresa e zyrave 

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

Mobile 073 4066 5946

FINANCIAL TIMES

Plani i diskutueshëm i kryeministres italiane Giorgia Meloni për të dërguar azilkërkuessit e shpëtuar, nga Deti Mesdhe në Shqipëri, ka hasur në një pengesë serioze pasi një gjykatë e imigracionit në Romë refuzoi dërgimin në offshore të grupit të parë të emigrantëve.

Në vendimin e saj, seksioni i imigracionit i gjykatës së Romës vendosi që 12 emigrantët meshkuj që mbahen në Shqipëri, me origjinë nga Bangladeshi dhe Egjipti, “kanë të drejtë të dërgohen në Itali” për shkak të “pamundësisë së njohjes së shteteve të origjinës së të ndaluarve” nga personat si “vende të sigurta”.

Gjykata u bazua në një vendim të fundit nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila vendosi më herët këtë muaj se vendet nuk mund të konsiderohen “pjesërisht të sigurta” me qëllim dëbimin. Një zyrtar italian konfirmoi se 12 emigrantët do të sillleshin në Itali për përpunim të mëtejshëm.

Vendimi është një pengesë e sikletshme politike për Melonin, e cila ka promovuar skemën e saj për mbajtjen e azilkërkuessve të mundshëm në qendrat në Shqipëri, si një mjet për të përbushur zotimin e saj për të reduktuar fluksin e emigrantëve të parregullt nga i gjithë Mesdheu. Plani i saj, dhe premtimi për përpunimin e kërkesave për azil në offshore, ka tërhequr interes të madh ndërkombëtar.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen e ka përshkruar atë si një shembull nga i cili mund të nxirren mësim. Edhe kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Sir Keir Starmer së fundmi i ka kërkuar Melonit në Romë më shumë detaje. Meloni shprehu shqetësim për vendimin, por këmbënguli se do të ishte vetëm një pengesë e përkohshme.

“FINANCIAL TIMES”: MELONI NË SIKLET PAS RRËZIMIT TË PAKTIT ME SHQIPËRINË

“Italianët më kanë kërkuar të ndaloj emigracionin e paligjshëm dhe unë do të bëj më të mirën”, – tha ajo gjatë një udhëtimi zyrtar në Liban. “Më vjen keq që në një kohë kur e gjithë Evropa po shikon diçka që Italia po përpiqet të bëjë, ne po përpiqemi, si gjithmonë, t’i fusim shkopinj në rrota”.

Meloni tha se ajo kishte thirrur një mbledhje urgjente të kabinetit të hënën për të diskutuar se si do të kapërcehen pengesat e reja ligjore. “Unë nuk mendoj se është kompetencë e gjyqtarëve të përcaktojnë se cilat vende janë “të sigurta” dhe cilat jo. Kjo është kompetencë e qeverisë. Ndoshta qeveria duhet të sqarojë më mirë se çfarë do të thotë një vend i sigurt” – tha ajo.

Italia ka shpenzuar deri më tani të paktën 60 milionë euro për ndërtimin dhe pajisjen e qendrave shqiptare, të cilat zyrtarisht nisën funksionimin të mërkurën me mbërritjen e 16 emigrantëve të parë.

Nga ai grup i parë, i përzgjedhur mes qindra njerëzve të shpëtuar në Mesdhe nga autoritetet italiane ditët e fundit, 4 u konsideruan menjëherë të papërshtatshëm për t’u mbajtur në Shqipëri dhe u dërguan në Itali, 2 të cilët mendohej se ishin të mitur dhe 2 për arsye mjekësore.

Senatori Lucio Malan, anëtar i partisë së djathtë të Melonit, “Vëllezërit e Italisë”, e quajti “skandaloz” urdhrin e gjykatës për të dërguar 12 emigrantët e mbetur në Itali.

“Disa magjistratë të politizuar kanë vendosur se nuk ka vende të sigurta të



origjinës” – shkroi në X senatori, i cili është pjesë e komitetit të marrëdhënieve me jashtë të senatit. “Është e pamundur të ndalosh ata që hyjnë ilegalisht; është e ndaluar riatdhesimi i emigrantëve të paligjshëm. Ata do të donin të shfuqizonin kufijtë e Italisë. Ne nuk do ta lejojmë këtë”, shtoi ai.

“Lega” e ekstremit të djathtë, partia e zëvendëskryeministrit Matteo Salvini, e quajti vendimin e gjykatës “të papranueshëm”. Ministri i Brendshëm Matteo Piantedosi tha në një konferencë shtypi të premten pasdite se qeveria do të apelojë kundër vendimit në një gjykatë më të lartë.

Avokati Lorenzo Trucco, president i Shoqatës për Studimin e Ligjit të Imigracionit, përshëndeti vendimin duke thënë se “shteti ligjor kishte mbizotëruar mbi aktet e paligjshme” të qeverisë duke theksuar “absurditetin dhe padrejtësinë” e marrëveshjes Itali-Shqipëri.

Marrëveshja e arritur mes Melonit dhe kryeministrit shqiptar Edi Rama vitin e kaluar i lejoi Italisë të ndërtonte dy qendra ndalimi emigrantësh në Shqipëri për të mbajtur deri në 3 mijë emigrantë, teksa autoritetet italiane përpunonin kërkesat e tyre për azil.

Marrëveshja specifikonte se qendrat do të mbanin vetëm burra të rritur të shëndetshëm nga vende që Italia i kishte konsideruar tashmë “të sigurt” për kthim të mundshëm. Ata që konstatohen se kanë kërkesa të vlefshme për azil do t’u jepet strehim në Itali, ndërsa ata që konsiderohen si emigrantë të paligjshëm do të kthehen në vendet e tyre të origjinës përmes një procesi të përshpejtuar.

Për t’u përgatitur për hapjen e qendrave, Italia në fillim të këtij viti caktoi 22 vende – përfshirë Bangladeshin dhe Egjiptin – si të sigurta për kthime

me disa përjashtime, si për disidentët politikë nga Egjipti dhe njerëzit LGBT+ nga Tunizia.

Një gjykatë e BE-së u shpreh se ligji evropian nuk lejon që vendet të kategorizohen si “pjesërisht të sigurta”, gjë që i dha formë verdiktit të gjykatës së Romës. Rregullat e reja të BE-së do të hyjnë në fuqi në vitin 2026, megjithatë ato do të lejojnë që vendet të përshkruhen si “të sigurta me përjashtime për disa rajone ose disa kategori njerëzish”.

Italia po kërkon të avancojë zbatimin e asaj pjese të paktit të emigracionit dhe azilit, tha një diplomat i BE-së. Von der Leyen, në një letër drejtuar liderëve të bllokut këtë javë, u angazhua për ta çuar rishikimin e konceptit të “vendeve të sigurta” deri në vitin 2025. ©Financial Times, LAPSI.al

KIM MEHMETI

E nxorën zvarrë nga makina?! Si të ishte kryebandit, vendndodhjen e të cilit mezi e kishte zbuluar policia, e jo ish-President i shtetit, i cili me asgjë nuk la të kuptohet se do ikte nga vendi apo do e shmangte përballjen me drejtësinë.

E Ilir Meta i sotëm, me asgjë nuk është më i ndryshëm nga ai i ditës kur u zgjodh President dhe kur Piktori e lëvdonte si më të mirin që kurdo qoftë e ka pasur Shqipëria. Përpos që asokohe Piktori shpresonte se do e kishte nën kontroll dhe se nuk do bëhej ky që është sot: armik i tij politik, i cili me asgjë nuk mund të shantazohet.

Tani të gjithë pyesin se kujt i nevojitej një spektakël i tillë që u ka hije vetëm shteteve që nuk janë shtete, por vël-

lazëri bandash? Pra, thuajse të gjithë shtiren se nuk e dinë se ky demonstrim force primitive ndodh vetëm në vende ku policia e mbron pushtetin e jo shtetin dhe ku duhet të shihet qartë se Shqipëria ka pasur mbret e diktator, por kurrë jo atë që ka sot: pronarin e vet – Piktorin!

Dhe duke qenë e tillë, çdo gjë në të, që nga Gjykata Kushtetuese e deri te SPAK-u, e kanë për obligim ta mbrojnë atë nga gjithë ata që mund ta rrezikojnë pronarin e saj - Piktorin. Si dhe të mos lejojnë që kushdoqoftë ta rrezikojë ‘aleancën e qelbësirave’ me përfaqësuesin e saj më të denjë: drejtuesin e shkollës së hajdutëve - Kryetarin e Bashkisë së Tiranës!

SPAK-U PO BËN ÇDO GJË PËR TË MBROJTUR PRONARIN E SHQIPËRISË, EDI RAMËN



Po pra, me këtë spektakël policor, Piktori ua ripërsëriti kundërshtarëve

të vet politik porosinë, të cilën vite me radhë ata assesi ta kuptojnë: se jo vetëm Shqipërinë, por edhe shqiptarët në të ai i konsideron si pengje në duart e hajdutëve të ‘Rilindjes’.

Sot pra e arrestuan ish-Presidentin e Shqipërisë. Edhe atë në mes të rrugës, duke e nxjerrë zvarrë nga makina, ashtu siç nuk do veprohej as me ndonjë kryemafioz të kërkuar me vite. Por siç mund të veprohej vetëm policia e Piktorit, të cilit askush nuk i ka treguar se ai që në luftën për t’i mënjano kundërshtarët e vet politik e përdor shpatën, ka vetëm një përparësi: paraprakisht e sheh vendin ku një ditë do rrokulliset edhe koka e tij!

THE GUARDIAN

12 azilkërkuesit që po mbahen në një qendër të re emigracioni italian në Shqipëri duhet të transferohen në Itali. Kështu vendosi gjykata, në një goditje të rëndë për një marrëveshje të diskutueshme midis qeverisë së ekstremist të djathtë të Romës dhe Tiranës, që synon frenimin e ardhjeve të emigrantëve.

Vendimi ngre dyshime të mëtejshme mbi realizueshmërinë dhe ligjshmërinë e planeve nga BE, të diskutuara të enjten, për të eksploruar mënyra të reja të krijimit të qendrave të përpunimit dhe ndalimit të emigrantëve jashtë bllokut, si pjesë e një qasjeje të re të vijës së ashpër ndaj migracionit. Vendimi i gjykatësve italianë do të thotë se kampi i ri i qeverisë së Romës, duhet zbratur pasi 4 nga grupi i parë prej 16 azilkërkuesish që mbërritën në qendrën e përpunimit u kthyen menjëherë në Itali të enjten.

Partia “Vëllezërit e Italisë” e kryeminstres italiane Giorgia Meloni, dënoi me zemërim vendimin në mediat sociale, duke fajësuar “magjistratët e politizuar” që “do të donin të shfuqizojnë kufijtë e Italisë. Nuk do ta lejojmë.”

Matteo Piantedosi, ministri i brendshëm, tha: “Ne do të apelojmë deri në gjykatën e kasacionit. Ne do të vazhdojmë me atë që Italia po arrin në Shqipëri dhe më tej do të bëhet ligj evropian”.

16 emigrantët, për të cilët qeveria italiane argumenton se duhet të kthehen përfundimisht në vendet e tyre “të sigurta”, në Egjipt dhe Bangladesh, mbërritën në portin shqiptar të Shëngjinit nga ishulli italian i Lampedusa me një anije ushtarake të mërkurën.

Sipas marrëveshjes, të nënshkruar nga kryeministrja e ekstremist të djathtë, Meloni, dhe homologu i saj shqiptar, Edi Rama, burrat e shpëtuar në ujërat ndërkombëtare që kalojnë nga Afrika në Evropë do të mbahen në qendër derisa pretendimet e tyre do të shqyr-

“THE GUARDIAN”: GJYKATA GODITI RAMA- MELONI QË PO “I SHIJONTE” DHE BE



Blow to Meloni's Albania deal as court orders asylum seekers' return to Italy

tohen.

Skema, e cila mund të përpunojë deri në 3000 burra në muaj, përjashton gratë, fëmijët dhe individët vulnerabël, të cilët do të dërgohen në Itali. Nga 4 personat e parë të kthyer në Itali, dy mendohej se ishin të mitur dhe dy konsideroheshin të pambrojtur.

12 të tjerët u konsideruan nga gjyqtarët në Romë si të rrezikuar nga dhuna nëse deportoheshin në vendet e tyre të origjinës, në një vendim që në fakt la në fuqi një vendim të 4 tetorit nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED).

Në Shqipëri mund të dërgohen vetëm emigrantët që vijnë nga një listë prej 22 kombesh të klasifikuara nga Italia si “të sigurta”. Egjipti dhe Bangladeshi janë mes tyre, por GJED vendosi që një vend jashtë bllokut nuk mund të shpallet “i sigurt” nëse i gjithë territori i tij nuk konsiderohet i sigurt.

Gjyqtarja Luciana Sangiovanni tha:

“Refuzimi i ndalimit të individëve në strukturat në Shqipëri që janë të barabarta me zonat kufitare apo tranzite italiane... po bëhet për shkak të pamundësisë së njohjes së shteteve të origjinës së individëve të ndaluar si “vende të sigurta”.

Analiza në “Corriere della Sera”: Meloni ka një rrugë të gjatë përpara Partitë opozitare dhe mediat kombëtare në Itali u shprehën se iniciativa, e cila do të kushtojë rreth 1 miliard euro për 5 vjet, ishte tashmë një dështim, duke vënë në dukje se qeveria kishte shpenzuar 250 mijë euro për transportimin e 16 personave në Shqipëri me një anije ushtarake. Partia Demokratike tha se plani kishte dështuar dhe Meloni duhet të kërkonte falje, ndërsa partia “Piu Europa” kërkoi dorëheqjen e ministrit të brendshëm, Piantedosit.

Një rrjet OJQ-sh që përfaqësojnë 160 organizata që mbështesin personat pa dokumente e ka përshkruar marrëveshjen italo-shqiptare si “çnjerëzore, absurde dhe një sistem të kushtueshëm që shkel detyrimet

ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”.

Michele LeVoy, nga Platforma për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Migrantët Pa dokumente (Picum) – tha se ishin “të tmerruar” nga mbështetja në rritje midis vendeve anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian për qendrat e emigrantëve në offshore.

“Përveç të qenit një marrëzi logjistike dhe financiare, është një sistem mizor që shkel ligjin ndërkombëtar dhe të BE-së dhe i vë njerëzit në rrezik abuzimi pa opsione të qarta për të marrë drejtësi dhe mjete juridike”, – tha LeVoy në një deklaratë.

Në një samit në Bruksel të enjten, liderët e BE diskutuan ngritjen e “qendrave të kthimit” – qendrave të përpunimit dhe ndalimit – në vendet jashtë bllokut dhe presidentja e komisionit, Ursula von der Leyen, tha se bisedimet se si mund të funksionojnë do të vazhdojnë.

Deklarata përfundimtare e samitit pasqyroi gjendjen e re të ashpër të

bllokut për migracionin, duke bërë thirrje për “veprime të vendosura në të gjitha nivelet për të lehtësuar, rritur dhe përshpejtuar kthimet nga BE duke përdorur të gjitha politikat, instrumentet dhe mjetet përkatëse të BE-së”.

Aktivistët dhe analistët kanë vënë në dyshim vazhdimisht nëse, krahasuar me një sistem azili të mirë-financuar, me bazë në BE, qendrat në offshore ose “pikat e nxehta të migrantëve” mund të konsiderohen ndonjëherë humane, efektive apo edhe legale sipas ligjit ndërkombëtar.

Përveç marrëveshjes së Shqipërisë me Italinë dhe një marrëveshjeje në shkallë më të vogël midis Danimarkës dhe Kosovës, në çdo rast është e paqartë se cilat vende jo-anëtare të BE-së mund të jenë të gatshme të presin qendra të tilla. Disa diplomatë dyshojnë se vetëm për këtë arsye, ideja mund të mos jetë fillestare.

Meloni tha pas samitit se kishte “shumë vende që shikojnë modelin e Shqipërisë” dhe disa liderë të tjerë të ekstremist të djathtë vlerësuan atë që kryeministri holandez, Dick Schoof, e përshkroi si “humor të ndryshëm në Evropë”.

Të tjerët, megjithatë, ishin të kujdesshëm, duke vënë në pikëpyetje shpenzimet, kompleksitetin dhe efektivitetin e një modeli “offshore”.

Emigracioni i parregullt i BE-së ka rënë që nga kriza e migracionit të vitit 2015 dhe ka rënë me më shumë se 40% këtë vit krahasuar me vitin 2023, por qasja e ashpër e bllokut pasqyron një varg suksesesh elektorale nga partitë e ekstremist të djathtë dhe anti-emigracionit. ©The Guardian, LAPSI.al

ILIR META

LUTFI DERVISHI

Ilir Meta mund të ishte sot duke dhënë mësim në fakultet por, ende pa mbaruar studimet në dhjetor të 90-tës, vendosi t'i futej rrugës së politikës për të kapur, si rrallë kush brenda tri dekadash, majat e profesionit të dytë më të vjetër në botë, politikës, si ministër, kryeministër, kryetar Parlamenti dhe president i Republikës.

Sot, ai u arrestua rrëmbyeshem me akuzat për pastrim parash, mosdeklarim pasurie dhe korrupsion. Bashkëshortja e tij dhe bashkëudhetarja politike deri para pak muajsh, hetohet në gjendje të lirë.

Akuza do duhet të provojë në gjykatë se “çfarë ka marrë Meta”, ndërkohë historia do të vlerësoje edhe çfarë ka dhënë ai në këto 30 vite.

I vetëbërë në politikë, Meta u bë kryeministri më i ri i tranzicionit, në moshën 29 vjeçare. I vlerësuar si kryeministër i suksesshëm me 1999-2001, Meta synoi shumë shpejt gjithçka. Dha dorëheqjen pas përplasjeve me kryetarin e PS Nano dhe u nxitua të krijonte LSI, më 2004. Nëse do të kishte përvojën e durimit strategjik, një vit më pas ai mund të ishte

kryetari i natyrshëm i PS.

Me LSI, Meta arriti të thejë përkohësisht dypolin PS-PD. Forca e krijuar prej tij bëri të mundur rotacionin me 2005 dhe 2013.

Aleanca me PS, më 2013 i dhuroi pushtet për herë të dytë LSI, pas 4 vjeçarit me PD. Aleanca me Ramën është dhe fillimi i fundit të LSI. Kur partia e krijuar prej tij nuk mundi të luante rolin e “king maker”, mbeti vetë “king”.

Katër vjet kryetar Parlamenti dhe 5 vjet president i Republikës ishin dhe

majat e pushtetit personal të Metës. Nga lartësia e kreut të shtetit ai përballoi dy “impeachment” nga shumica që e zgjodhi, por pa edhe rrudhjen e LSI, që u mundua ta ripërtërijë pas mandatit presidencial (2017-2022), duke e riformtuar si Partia e Lirisë.

“Pushteti lodh ata që nuk e kanë!” Lëre pastaj ata që e kanë! Kjo maksimumë u provua me Metën dhe partinë e tij.

Akuzat për korrupsion, përballjet në vite me prokurorët, paranoja që sjell për cilindo qoftë pushteti i gjatë, retorika e pakontrolluar, i sollën kosto

politike, familjare dhe se fundmi edhe ligjore.

Në gjykatë Meta do të ballafaqohet me një hetim 5-vjeçar të SPAK për pastrim parash, mosdeklarim pasurie dhe korrupsion.

Meta sot po përjeton një nga episodet më të errëta të karrierës së tij. Ashtu siç historia do të tregojë çfarë ai ka dhënë për politikën shqiptare dhe për vendin, drejtësia do të tregojë se çfarë ka marrë prej tyre.

Tani, beteja e radhës e Metës është me drejtësinë, që mund të vendosë epilogun e një karriere të mbushur me kontradikta. Në politikë ai ka vertetur thënien se mund të vdesë disa herë!

LIGJI PËR AGJENTËT E HUAJ KËRCËNIM PËR DEMOKRACINË NË MAL TË ZI

Kërkesa e partive pro-serbe dhe pro-ruse, që janë pjesë e qeverisë në Mal të Zi, për miratimin e ligjit për agjentët e huaj vlerësohet nga analistët malazezë si kërcënim serioz për demokracinë por edhe për integrimin evropian të vendit.

Këto kërkesa, sipas tyre, janë absurde dhe miratimi i një ligji të tillë rrezikon rrugën e Malit të Zi drejt integritimit në Bashkimin Evropian.

“Përmendja e miratimit të një ligji të këtillë është absurde, aqë më shumë kur Mali i Zi pretendon dhe është një shtet që po bën hapa për tu integruar në BE. Aqë më shumë kur dihet se këto ligje përcaktohen me rregulla dhe norma që janë të nivelit ndërkom-bëtar dhe që nënkuptojnë lëvizjen e kapitalit në mënyrë të lirë”, thotë analisti dhe publicisti Haxhi Shabani.

Analisti Muzafer Beli Çausi shpreh habinë se si një kërkesë e tillë mund të vijë nga parti dhe organizata, duke shkaktuar shqetësim dhe konfuzion në opinionin malazez.



“Një nismë e tillë lë një shije të hidhur në opinion dhe shkaktonte shqetësim dhe hutë, duke na përkujtuar se si në

hapësirën tonë ka parti dhe organizata që ende e kanë mendësinë e së kaluarës”, thotë zoti Çausi.

Ai thotë se një ligj i tillë mund të kufizojë hapësirën për veprim civil që ndihmon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Malit të Zi dhe të pengojë punën e mediave të pavarura.

Edhe analisti Haxhi Shabani vë në dukje se një ligj i tillë do të krijoj probleme në funksionimin e shoqërisë civile dhe të mediave.

“Mund të vihet në pikëpyetje funksionimi i disa shoqatave, të cilat kanë marrë fonde pikërisht për mënyrën si funksionon demokracia. Këto shoqata kanë përcjellë fushatat zgjedhore dhe zhvillimin e zgjedhjeve ku në një farë mënyre janë një mekanizëm i cili përcakton se sa plotësohen standardet ndërkom-bëtare në nivel të zgjedhjeve, por edhe në nivel të mediave sepse mediat në Malin e Zi kanë një hapësirë shumë të ngushtë dhe mediat e

pavarura gjithmonë kanë qenë një pretendim më shumë se sa kanë funksionuar”, tha analisti Shabani.

Ndërkaq analisti Ismet Kallaba këtë nismë e sheh si pjesë të agjendës së partive pro-serbe dhe pro-ruse, me qëllim të ndikimit në politikën shtetërore të Malit të Zi.

“Në këtë kontekst këtë do ta lidhja edhe me përpjekjet tjera dhe nisma për ndryshimin për shtetësinë, konkretisht për miratimin e dyshtetësisë për qytetarët e Malit të Zi”, tha zoti Kallaba.

Analistët thonë se nevojitet mbrojtja e menjëhershme e veprimtarisë së lirë dhe të pavarur të shoqërisë civile në Mal të Zi dhe të parandalohet miratimi i ligjeve që do të kërcënonin vlerat demokratike./VOA

XHELADIN ZENELI

Në pushtetin aktual në Mal të Zi, shqiptarët janë të përfaqësuar me katër pozita të rëndësishme. Ata ushtrojnë pozitën e nënkryetarit të qeverisë, të nën kryetarit të parlamentit dhe drejtojnë me dy ministri. Ky është një përfaqësim politik i cili erdhi si rezultat i kualicionit të subjekteve të caktuara politike shqiptare me subjektin politik Lëvizja ‘Europa Tani’ (PES), subjekt ky i cili fitoi mandatin për formimin e qeverisë në zgjedhjet parlamentare që u mbajtën vitin e kaluar në Mal të Zi. S’ka dyshim se nga perspektiva e faktorit politik shqiptar, ky përfaqësim i tanishëm politik i shqiptarëve mund të radhitet si ndër arritjet më të mëdha të tyre gjatë periudhës së pluralizmit politik në Mal të Zi.

Por, shtrohet pyetja se si qendron situata e përfaqësimit (punësimit) të përgjithshëm të shqiptarëve në nivelet e tjera të shërbimit publik, organeve, institucioneve dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe sa reflektohet ky përfaqësim i lartë pushtetar i tyre në Mal të Zi në ngritjen e të punësuarve të tjerë shqiptarë në këto institucione ?.

Megjithëse viteve të fundit, pra që nga ndërrimi i pushtetit në Mal të Zi në vitin 2020 nuk kemi ndonjë raport zyrtar i cili tregon numrin apo përqindjen e shqiptarëve në organet e shërbimit publik (shtetëror), dihet mirë se shqiptarët vazhdojnë të jenë të marginalizuar në këtë aspekt. Pra, edhe përkundër funksioneve të larta që shqiptarët ushtrojnë kohë pas kohe në qeveri, numri i përgjithshëm i të punësuarve shqiptarë në institucionet publike dhe ndërmarrjet shtetërore vazhdon gjithnjë të mbetet simbolik

SA JANË SHQIPTARËT TË (NËN) PËRFAQËSUAR NË ORGANET DHE INSTITUCIONET SHETËRORE NË MAL TË ZI ?



dhe nën nivelin e përfaqësimit të tyre proporcional.

Papunësia në vendbanimet shqiptare është mbi mesataren e papunësisë së përgjithshme në Mal të Zi. Kohë më parë portali informativ UlqiniOnline publikoi një të dhënë e cila konstatoj se në ‘Ulqin janë ‘26 magjistra të papunë’. Është interesant se ky lajm erdhi përafërsisht në të njëjtën kohë kur u bë edhe rikonstruktimi i qeverisë së Malit të Zi, pra në muajin korrik të këtij viti, lajm ky i cili muar një vëmendje të jashtëzakonshme mediatike, kurse lajmi i ‘magjistarve të papunë’ për çudi nuk nxiti shqetësimin dhe vëmendjen e askujt.

Elita politike e privilegjuar, me bazën

e vet zgjedhore të diskriminuar ?!

Shqiptarët përbëjnë rreth 5% të numrit të popullsisë së Malit të Zi dhe përfaqësimi (punësimi) i tyre në organet shtetërore dhe ndërmarrjet publike vazhdon të jetë gjithnjë shumë i ultë në krahasim me përqindjen e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë në këtë shtet.

Për fat të keq mos përfaqësimi i duhur dhe proporcional i shqiptarëve në institucionet publike dhe shtetërore është një dukuri që është trashiguar nga pushteti 30-të vjeçar të DPS-it (Partisë Demokratike të Socialisteve). Statistikat zyrtare të kohës së pushtetit të DPS-it tregojnë se shqiptarët në Mal të Zi nuk e kanë kaluar

asnjëherë prapë e 1.3% të përfaqësimit të tyre në organet e shërbimeve publike dhe institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore, çka do të thotë se për një kohë të gjatë atyre iu është mohuar një e drejtë themelore kushtetuese.

Vlen të theksohet gjithashtu se gjatë shumicës së kohës së pushtetit të DPS-it, drerisa në njërin anë shqiptarët ishin pjesë e atij pushteti dhe mbanin pozita të larta shtetërore, në anën tjetër dhe në mënyrë paradoksale, pjesa tjetër e shqiptarëve nuk ishin të përfaqësuar (punësuar) në mënyrë proporcionale në organet shtetërore dhe administratën publike në Mal të Zi. Pra, e kaluara na mëson se përfaqësimi politik i shqiptarëve përmes posteve dhe funksioneve të larta qeveritare, domosdoshmërisht nuk reflekton dhe nuk ndikon edhe në punësimin e përgjithshëm të shqiptarëve në nivelet e tjera shtetërore. Kjo ka ndikuar, që në njërin anë të kemi një elitë politike të privilegjuar, kurse në anën tjetër baza e saj zgjedhore e diskriminuar.

Rikujtojmë edhe një herë Kushtetutën e Malit të Zi, (Nenin 79, pikën 10 të saj), ku thuhet se pjesëtarët e popujve pakicë, ku përfshihen edhe shqiptarët, u ‘garantohet e drejta e përfaqësimit proporcional’ në organet e shërbimit publik, në orgnet e qeverisjes shtetërore dhe atyre të vetëqeverisjes lokale. Për 34 vite me radhë shqiptarëve iu është mohuar një e drejtë e tillë dhe kanë pësuar diskriminim të vazhdueshëm në përfaqësimin

(punësimin) proporcional të tyre. Asnjë qeveri e Malit të Zi, deri më sot nuk ka arritur që ta plotësojë apo realizojë këtë të drejtë të tyre kushtetuese. Përgjegjësi për mos realizimin e përfaqësimit (punësimin) proporcional të shqiptarëve në Mal të Zi, mbajnë edhe ato subjekte politike shqiptare të cilat përmes përfaqësuesve të vet, kanë bashkëqeverisur dhe kanë qenë pjesë e atij pushteti.

Edhe qeveria e tanishme e cila në përbërjen e vet ka katër pjesëtarë të përkatësisë shqiptare me poste të rëndësishme, e ka filluar mandatin e vet me mos përfaqësimin proporcional të shqiptarëve në organet dhe institucionet e tjera të shërbimit publik në Mal të Zi. Kur këto funksione dhe pozita të larta që shqiptarët mbajnë sot në qeverinë aktuale të Malit të Zi nuk pasojnë me rritjen e numrit të punësimeve të shqiptarëve në përgjithësi në nivelet e ndryshme të institucioneve shtetërore dhe publike, atëherë ashtu si në të kaluarën, këto poste shtetërore do të shihen nga të tjerët vetëm si avancim dhe arritje të karrierave të tyre personale dhe jo si një angazhim serioz edhe për punësimin e shqiptarëve në ndërmarrjet dhe institucionet e tjera shtetërore, gjithnjë sipas rregullit të përfaqësimit (punësimin) proporcional të tyre.

Mbetet të shihet në të ardhmen nëse do të ndryshojnë diçka pozitivisht në këtë drejtim por mendoj se egziston një skepticizëm i arsyetuar që kjo do të vazhdojë të jenë një çështje e pazgjidhur edhe gjatë mandatit të kësaj qeverie.

ANDI BUSHATI

DERRAT E ORWELLIT DHE RILINDASIT E DREJTËSISË SË RE

Pa ndonjë surprizë të madhe Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për pezulimin e dënimit të ish deputetit Ervin Salianji duke thëlluar edhe më tepër instalimin e dy standarteve të drejtësisë së re atlantiste. Interesant në këtë akt nuk është vendimi i pritshëm i gjykatësve, por argumentat e mbrojtjes që ata këndë hedhur poshtë.

Në 12 faqet që avokatët kishin depozituar tek togat e zeza “më të kualifikuara të vendit”, një pjesë të rëndësishme e zinte krahasimi diskriminues midis ndërprerjes së mandatit të një të zgjedhuri nga populli, që i përkiste opozitës dhe mbetjes në parlament të një të ngjashmeje të tij që i takonte qeverisë. Paralelet hiqeshim me rastin e ish ministres së jashtme Olta Xhaçka. Pa qenë në gjendje të gjykoj se sa efekt mund të kenë këto argumenta nga ana juridike, mendoj se shqyrtimi i tyre, jep për publikun e gjërë, një pasqyrë ulëritëse të kritereve të dyfishta që janë instaluar në këtë vend.

Le ti marrim me radhë. Ndonëse Gjykata Kushtetuese, një herë bëri pirueta për të ndihmuar mazhorancën, ndërsa herën e dytë e detyroi me vendim parlamentin që të votonte për ti shpënë asaj rastin e “investitorit strategjike”, kjo e fundit qëndron ende e pa shqetësuar në kuvend. Mandati i saj vijon pa të keq dhe me siguri kështu do të jetë deri në fillimin e fushatës së ardhshme. Nga ana tjetër Ervin Salianji i’u dogj pa një pa dy besimi që i dhanë zgjedhësit në 2021-shin, ende pa pritur qoftë dhe zbardhjen e vendimit, por duke u mjaftuar vetëm me dizpozitivin.

Së dyti, deputetja e PS e mban ende detyrën, ndonëse kryebashkiaku që dha truallin në të cilën u implikua emri i saj u burgos nga SPAK për korrupsion. Nga ana tjetër Salianji u zhvesh prej saj dhe përfundoi në burg vetëm prej “rrëfimit” të një dëshmitari të përpunuar dhe të paguar nga policia



e Fierit.

Së treti, me faj ose jo, Xhaçka akuzohet se ka përfutuar nga posti si anëtare qeverie dhe se ka vepruar në konflikt interesi, ndërsa kolegu i saj opozitar, në mirë apo në keq besim, ka pasur si qëllim interesin publik, duke dashur të pengojë një trafikant që të përfitonte nga qenia e të vëllait ministër i brendëshëm.

Pra ai që denoncon e pëson, ndërsa ai që abuzon është i nderuar.

Por, fatkeqësisht, ky nuk është rasti i vetëm ku lidhja okulte e politikës me ata që “do i jepnin fund epokës së pandëshkueshmërisë”, prodhon standarte të dyfishta.

Po të shikosh procesin kundër Sali Berishës, që qëndron i izoluar pasi akuzohet se ka prodhuar vendime qeverie dhe votime parlamenti për të

favorizuar dhëndrrin e tij në privatizimin e klubit Partizani, vë duart në kokë. Me të njëjtin standart Edi Rama duhej të kalbej prej kohësh në burg, jo vetëm sepse ka bërë të njëjtin gjë për inceneratorët që mbetën në letër, por se ka shkuar edhe më tej, duke miratuar bonusin për një kompani që nuk ekzistonte, pavarësisht se ministrat e tij e kishin vënë në djeni për këtë gjë. Por ndërsa Berisha po i afrohet fushatës ekektorale si lider i izoluar, SPAK, as ka guxuar ta pyesë kryeministrin aktual, qoftë edhe si person që ka djeni për vjedhjen e shekullit.

Po të njëjten fabul përforcon edhe procesi i atij që konsiderohet nga opozita si i burgosuri i tretë politik në vend, Fredi Belerit. Pa marrë parasysh se ai u dënua me prova dhe dëshmitarë të manipuluar, pra qoftë edhe duke prezumuar se gjithçka në procesin e tij qe e rregullt, sërish ka diçka që ulëret. Si ka mundësi që

drejtësia u alarmua për 8 vota të ish kandidatit të Himarës, që sipas saj nuk vlenin së bashku më shumë se 3 mijë euro dhe nuk e ka vënë ende ujin në zjarr për vjedhjen sistemike të votës, që gjithë Shqipëria e dëgjoi me veshët e saj falë përgjimeve të publikuara prej Bild-it. Apo mos vallë një i votuar minoritar bëhet më kollaj kokë turku, sesa e gjithë partia shtet, e impikuar në manipulimin elektoral të Dibrës dhe Durrësit?

Prandaj dhe mbrojtja e Salianjt, ndonëse ashtu sikurse pritej nuk pati sukses, bëri mirë që e vuri theksin tek trajtimi i diferencuar, i vendosur nga lidhja okulte qeveri drejtësi, ku opozitarët diskriminohen, ndërsa pushtetarët favorizohen.

Reforma e euro-amerikanëve e cila u propogandua se kishte qëllimet më të larta, sot ka degraduar në një farsë të denjë për romanet e Orwellit. Më mirë sesa gjithçka asaj i shkon shpre-

hja e stërpërdorur e fiksionit të shkrimtarit vizionar, për një regjim ku të gjitha kafshët janë të barabarta, por ama ka dhe disa që janë më të barabarta se të tjerat. Njësoj edhe sot ata që japin drejtësi në bashkëpunim me rilindjen i ngjajnë derrave të “Fermës së kafshëve”, që e vranë parimin e të qenit të barabartë përpara ligjit. Pikërisht për këtë, një deputet i opozitës e humbet mandatin, ndërsa tjetri i qeverisë jo; një ish kryeministër izolohet, ndërsa i njëjti mëkat për pasardhësin nuk konsiderohet faj; një kandidat që dyshohet se ka blerë pak vota shkon në burg, kurse ata që e kanë industrializuar manipulimin e zgjedhjeve quhen fitimtarë.

Kjo është ripërtitja e pushtetit të derrave dhe ne nuk po përjetojmë asgjë më shumë se sa na ka parathënë këtu e tetë dekada më parë Orwelli.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



ARMAND SHKULLAKU

Eksperimenti euro-atlantik, se në një vend ku të gjitha pushtetet i kontrollon një njeri i vetëm, mund të ndërtohen institucione të pavarura, ashtu siç pritej, dështoi me sukses. Ndonëse historia politike nuk njih ndonjë rast ku regjimet autokratike të bashkëjetojnë me segmente të lira dhe demokratike, shqiptarëve iu rrëfyte përralla se diçka e tillë mund të bëhej realitet nëse mbështetej nga partnerët strategjikë. Pastaj përralla u shndërrua në një iluzion, ku “heronjtë e rinj të fëmijëve tanë” do të ndesheshin dhëmbë për dhëmbë me krimin dhe korrupsionin dhe, më në fund, shqiptarët do të jetonin të lumtur përgjithmonë. Paradoksi regjim autoritar-institucione të pavarura, u pranua si normalitet dhe SPAK u vizatua si qerosi që ia del i vetëm të presë kokat e kuçedrës. Sot, ky iluzion i rremë ka rënë, por zhgënjimi nga një iluzion mund të jetë më traumatik se sa një realitet i kalbur. Ai mund të vrasë përfundimisht shpresën për ndryshim dhe nervin për të reaguar.

Dështimi i paralajmëruar i eksperimentit shqiptar ndodhi përditë nga pak në sytë e të gjithëve, përfshi edhe të atyre që e sponsorizuan politikisht dhe financiarisht me taksat e qytetarëve të tyre, deri sa mbërriti në pikën pa kthim ku gjendet sot. Thjesht nuk deshën ta shohin dhe refuzuan ta pranojnë. Aksioma se s’mund të ketë drejtësi të pavarur në një shtet të kapur, u vërtetua që në krye të herës.

SPAK, ARMA E RE E RAMËS PËR TË VRARË RIVALËT POLITIKË



Kur nisën emërimet në organet e vetingut dhe në këshillat e prokurorisë e gjykatave. Kur u grabitën anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe u çuan të betohen buzë Lanës. Kur u dogjën ata që nuk ishin të partisë dhe kaluan ata që ishin të “krushqisë”. Dhe mbi të gjitha, kur reforma e famshme në drejtësi, që do ndëshkonte të paprekshmit, përkoji në kohë me projektimin dhe zbatimin e dy prej aferave më spektakolare të korrupsionit, që vazhdojnë ende, inceneratorët dhe e famshja 5D.

Përballë evidencave të qarta se edhe pushteti i drejtësisë së re po rreshtohet me shokët në sqtullën e Edi Ramës, iluzioni i madh ia lë vendin një më të vogli, në mos shpresëdhënës të paktën ngushëllues se investimi i reformës nuk kishte vajtur për dhjam qeni. Ky iluzion i vogël ishte sa qesharak aq edhe therrës: Edi Rama vërtetë ka ndikim mbi drejtësinë e re, por aty brenda ka individë që nuk i kontrollojnë dot. Pra institucionet e pavarura u katandisën në ca individë të pavarur.

Sigurisht edhe ky mini iluzion e kishte jetën të shkurtër. Në kohë rekord, kryeministri vuri në rresht SPAK-un, gjykatat speciale, gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese, në funksion të pushtetit të tij. Paralajmëroi Fredi Belerin nga studio e emisionit Opinioni dhe policia, prokuroria, të gjitha shkallët e gjykatave e çuan deri në fund urdhërin e arrestimit dhe grabitjes së mandatit të Himarës. Kërçënoi Ervin Saliqin live në Kuvend dhe gjykata e Apelit nuk ia bëri fjalën dysh. Kërkoji të linçohet “tradhëtari” Arben Ahmetaj dhe prokurorët i nxorrën dhe vibratorët nga dhoma e gjumit. Urdhëroi nga Kongresi të arrestoheshin Berisha dhe Meta dhe SPAK me krenari mund të deklaroi se ia çoi fjalën në vend.

Sot nuk ka më asnjë iluzion se drejtësia e re është në fakt arma e re në duart e Edi Ramës për të asgjësuar përpara zgjedhjeve opozitën dhe çdo kundërshtar politik. Nëse në zgjedhjet e kaluara përdori ndryshimin e kodit zgjedhor me vota të trafikuar dhe ndërkombëtarët heshtën me turp, për zgjedhjet e ardhshme po përdor drejtësinë e re që vetë ndërkombëtarët ia bënë dhuratë. Deri tani, “heronjtë e fëmijëve tanë” i kanë hequr qafe dy krerët e opozitës, njërin të izoluar në

shtëpi dhe tjetrin të tërhequr zvarrë në qeli.

Pandëshkueshmëria e para 15 vjetëve po rezultojnë më e rëndësishme se ajo që grabit aktualisht miliarda nga taksat e shqiptarëve. Sepse standarti I SPAK nuk është interesi publik por shërbimi politik. Ata që mund t’i prishin punë Edi Ramës për zgjedhjet e ardhshme nuk preken, paçka se janë kapur me preshë në duar e në gojë. Dosja e Çyrbes ndalohet të publikohet, ndërsa ajo e Ilir Metës shpërndahet me entuziasëm. Firmat e “shefit” nuk mund të hetohen, por ato të para 15 viteve s’mund të amnistohen. Korrupsioni i kundërshtarëve të Ramës është banal, ndërsa i atyre që vjedhin ditën për diell është intelektual.

Dhe ky përdorim i drejtësisë së re, njësoj siç përdoren taulanët, helanet, spirot dhe palët, nuk është thjesht fundi i iluzionit euro-atlantik se në regjimet e korrupsionit mund të krijosh institucione të pavarura. Ai është degradimi përfundimtar i një shoqërie, që duartroket liderin suprem si kur cakton me votat e tij presidentit e vendit ashtu edhe kur urdhëron drejtësinë e re ta burgosë atë.



ALFRED LELA

Si asnjëherë më parë, kritikët dhe kundërshtarët e opozitës në media, ranë dakord se arrestimi i ish-Presidentit Meta ishte një tejkalim i dhunshëm dhe pa shije, jo vetëm i kompetencave policore dhe ligjore. Eshhtë e rëndësishme të theksohet fakti se, kjo sjellje nuk është çështje stili dhe as mase, por shpjegon se si pushteti del mbi shtetin dhe urdhri mbi ligjin.

Edhe pse joprofesionalizmi banditesk i policëve të maskuar, na bëri me dije se, në Shqipëri, shpagimi është më i rëndësishëm se procesi, ne duhet të ndalemi këtu sepse pas kësaj fshihet

META-SALIANJI, PËRPIEKJA PËR TË ZHBËRË TË DREJTËN PËR RETORIKË TË KUNDËRSHTARIT

një rrezik i madh.

Si në rastin kur policët po shpagueanin veten (i ka sharë Meta), si kur po shpagueanin shefat e tyre në ministri, apo edhe nëse po e bënin për Dumanin dhe Ramën, me të cilët kryetari i PL është mbërthyer në betejat retorike (sharje), shkelja mbetet.

Rreziku që ky brutalitet sjell, së pari nëse nuk identifikohet dhe pranohet, dhe së dyti nëse nuk kundërshtohet, është alarmant për çdo operator të hapësirës publike në Shqipëri, nga politikanët e deri te analistët apo aktorët e shoqërisë civile.

Protagonistët e sistemit të drejtësisë, nëse nuk thellohen dot në ‘krime intelektuale’ të pushtetit, duhet të ravigojnë fort në atë se çfarë është një aktor politik. Për definicion, një protagonist i politikës është një aktor i retorikës, pra ai ka ligjërimin, të folmen, narrativën si instrumentin e parë të shfaqjes dhe të përbaljes me dhe në hapësirën publike. Këtë instrument e

përdor brenda një kornize të madhe, që quhet liria e shprehjes. Retorika brenda lirisë së shprehjes vjen dhe takohet me një përmasë të tretë që është stili i atij/asaj që e bart apo e bën retorikën, gjë që ndryshon nga individë në tjetrin sipas formimit, prejardhjes, ideologjisë, misionit etj.

Pasë siguruar këtë nocion, i bie që Ilir Meta është arrestuar në atë formë për stilin e tij retorik, brenda lirisë së shprehjes, si aktor politik. Pra është një arrestim absurd dhe banditesk. Është si të arrestosh, në tejkalim të çdo protokollit policor dhe ligjor, Donald Trump-in i cili para pak ditësh tha publikisht se, për herë të parë e kuptoi se edhe burrat mund të kenë menstruacione kur pa Tim Walz (kandidatin demokrat për zv/President). Apo për mijra batutat dhe deklaratat e tij që, edhe këta të SPAK, GjKKO dhe Policisë duhet t’i kenë parë (nëse nuk i kanë lexuar) nëpër meme (të përthyer edhe në shqip).

Ku qëndron rreziku për politikanët

dhe çdo aktor tjetër të hapësirës publike pas ‘precedentit Meta’, të vendosur në mënyrë banditeske nga Policia me urdhra prej tjetërkund? Thjesht fare: krijon një aparat censure dhe autoncensure ndër ta, pasi kanë regjistruar në subkoshiençë atë që i ndodhi Metës. Në këtë mënyrë, jo vetëm komunikimit publik i është zhbërë instrumenti kryesor-retorika, por edhe i ka dalë kundër precedentit. I njëjti precedent mund të përdoret nesër kundër Ramës kur të mos jetë në pushtet. Do të ketë gjithmonë policë që në zellin e idiotit lëshohen vrik pas çdo fërshëllime të padronit të radhës, duke mos ditur të ndajnë urdhrin nga ligji. Do të ketë gjithmonë shpagues profesionistë, që nuk e ndajnë dot pushtetin nga shteti.

Një i tillë u dëshmuar psh ministri i Brendshëm kur, për herë të dytë, mori anën e dhunës policore dhe (çka është galletë) e bëri këtë duke përdorur retorikën politike. Pra, të njëjtin instrument për të cilin ndëshkon dhe godet Metën, ia njih të drejtën vetes ta pë-

dorë pa kufi. Automatikisht, këtu biem në përkufizimin e një shteti autoritar apo diktatorial: Ti nuk i lejon kundërshtarit tënd të njëjtat mjete të lirisë. Nuk ka përkufizim tjetër për diktaturën, për të gjithë ata që hapin sytë kur u thua se vendi po rrëshqet në gropën e saj.

Edhe deputeti i PD, Saliqin, është një dëshmor i retorikës politike. Ai ka folur dhe ka pësuar. Ai ka marrë fakte të provuara apo të dhëna të konceptuara prej tij si fakte dhe i ka bërë publike me anë të retorikës. Për këtë është në burg.

Ata aktorë politikë dhe mediatikë në anën e pushtetit, janë në të drejtën e tyre të mos e pranojnë këtë përkufizim, por duhet të rrinë gati, sepse fara e precedentit është si e gramit. Ngulmon dhe mbin me egërsi dhe shpeshësi edhe kur ti pandeh se e ke shkullur.

DITMIR BUSHATI

NJË SHËNIM PËR PRINDËRIT
TANË DHE BREZAT E
ARDHSHËM.

Para një viti ftova në podcastin tim “Public Square”, Arjan Gjonça, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës (LSE) dhe ekspert i Kombeve të Bashkuara për çështjet e popullimit dhe të arsimit, me të cilin diskutova për tri reziqe që i kanosen shoqërisë shqiptare: i) skema e pensioneve; ii) kujdesi shëndetësor; iii) kujdesi shoqëror.

Në të vërtetë, këto janë sfida për çdo shoqëri të përgjegjshme që respekton kontributin e prindërve duke hapur shtigjet e së ardhmes për fëmijët. Pasi, siç thotë me të drejtë Jacques Attali: “Nuk mund të jetojmë në kurriz të brezave të shkuar dhe atyre të ardhshëm. Të parëve ua hamë kontributin, të dytëve ua rrënojmë trashëgiminë”.

Është pozitiv fakti që qeveria e ka kthyer si temë dite skemën e pensioneve, sikundër fushatën komunikuese me sipërmarrjen për deklarimin real të pagave, çka ndihmon ekonominë dhe skemën e pensioneve. Mirëpo, në mënyrë që këto sfida të adresohen dhe të mos mbesin në nivelin e retorikës së ditës, nevojitet ballafaqimi me poli-



tikat e zbatuara deri tani, sikundër ndërmarrja e reformave rrënjësore. Shifrat tregojnë se reforma e skemës së pensioneve të vitit 2014 nuk dha efektin që pritej. Sepse nuk është zgjeruar baza e kontribuesve, shoqëria është plakur, dhe forca aktive e punës vijon të largohet nga vendi. Pensionistët e rinj në skemë në vitin 2023 kanë kontribuar mesatarisht vetëm 27 vite, ndërkohë në vitin 2013 pensionistët e rinj kontribuonin në skemë

mesatarisht 31 vite.

Gjithashtu, mbështetja buxhetore e skemës së pensioneve ka rënë. Në vitin 2020 ajo ishte 1.96 % e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa në vitin 2023 vetëm 0.63% e PBB-së. Ndaj, mosdeklarimi apo nëndeklarimi i pagave nuk është i vetmi faktor që ka penguar rritjen e pensioneve.

Hendeku financiar mes asaj çka nevo-

jitet dhe thellimit në kontribut nga paguesit e tanishëm nuk mund të mbushet pa zgjerimin e bazës me kontribues të rinj dhe pa mbështetje buxhetore, që vjen si pasojë e përcaktimit si prioritet nga ana e qeverisë. Skema e pensioneve nuk ‘shërohet’ dot vetëm nëpërmjet të ardhurave të grumbulluara nga kontribuesit e sigurimeve shoqërore. Pasi për shtesën 16 mijë -18 mijë pensionistë në tregun e punës duhet të hyjnë 22 mijë - 23 mijë të punësuar.


Që të ketë kontribues të rinj ne duhet të pranojmë se skema e pensioneve është vetëm pika fundore e një sistemi që në thelb ka edhe dy elementë të tjerë po aq të rëndësishëm: kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen shoqërore. Këto elementë e kanë gjenezën tek mirëqeverisja dhe modeli ekonomik. Pa rishikimin e modelit ekonomik të tanishëm, i cili mbështetet në “privatizimin e përfitimeve dhe shoqërimin e riskut”, nuk mund të ketë as skemë pensionesh të qëndrueshme dhe as frenim të largimit të njerëzve nga vendi.

Ekonomia shqiptare mbështetet kryesisht në degë si ndërtimi apo turizmi, që janë të përkohshme për mënyrën si duhet të zhvillohet vendi dhe nuk ofrojnë një perspektivë afatgjatë.

Ne na duhet një ekonomi me produktivitet të lartë, që bazohet tek dija, në mënyrë që të krijojë të ardhura më të mëdha dhe një shtresë të mesme të qëndrueshme. Pa arsim cilësor dhe dije është i pamundur produktiviteti i lartë. Njëkohësisht, na duhet të nxisim degët e reja të zhvillimit që bazohen tek industria e gjelbër, të zhvillojmë burimet energjitike, burimet minerare për zhvillimin e industrisë së rëndë, dhe të orientojmë burimet njerëzore drejt degëve të reja.

Gjithashtu, nevojiten politika aktive që formësojnë ekonominë e jetës. Pra, më shumë demokraci, më shumë shëndet, më shumë arsim, më shumë ushqim të përballeshëm dhe të shëndetshëm, dhe natyrisht siguri.

Për të dalë nga kjo situatë na duhet të rishpërndajmë burimet dhe të ardhurat, por mbi të gjitha duhet të rishpërndajmë burimet e dijes dhe aftësive përmes arsimit. Pabarazitë e statusit social-ekonomik, e të ardhurave dhe mundësive të jetës, nuk zgjidhen me fushata, lëmshë, e as me gjelin e detit të fundvitit. Ato duhet të përbëjnë boshtin e veprimit të një qeverisje që orientohet për nga vlerat e të majtës demokratike.



EMIN AZEMI

Në betejat identitare që patën maqedonasit me fqinjët, shqiptarët i patën jo vetëm aleat, por edhe kalorës të vijave të para të frontit. Për pasojë, shumë çështje që duhej të hapeshin në favor të avancimit të statusit juridik e kushtetues të shqiptarëve, u prolonguan dhe u futën nën rrogë, në favor të një procesi me karakter identitar që maqedonasit kishin nevojë ta fitojnë ndaj fqinjëve. Dhe çka ndodhi pastaj?

Gjykata Kushtetuese, si një mekanizëm juridik që do të duhej të ruaj kohezionin e brendshëm etnik e qytetar në Maqedoninë e Veriut, si duket është në rrugë ta bëjë të kundërtën.

Fillimisht ajo e ka ndërmend ta reduktoj edhe më tej hapësirën ligjore në përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, si fazë e parë e përpjekjeve për ta çmontuar Marrëveshjen e Ohrit (nga heqja e balancuesit e deri te menjanimi i Badinterit, si një mekanizëm që mbron pakicën nga vendimarrja majorizuese e shumicës).

Ditëve të fundit lexuam në media se Gjykata Kushtetuese tash më e ka në sirtar vendimin për shfuqizimin e tre neneve kryesore të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, kryesisht nenin që parashikon gjuhën shqipe në monedhat e Maqedonisë së Veriut, nenin për gjuhën shqipe në uniformat e policisë dhe ushtrisë, si dhe nenin që lejon përdorimin e gjerë në gjyqësi.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese lehtësisht mund të përdoret si levë juridike-ndihmëse për të gjitha ato struktura politike e parapolitike në Maqedoninë e Veriut që janë kundër barazisë etnike e qytetare dhe për rrjedhojë favorizojnë dominimin e një etnie ndaj etnive të tjera.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është një bidon me benzinë që qën-

dron në ‘bodrumet’ e mendësisë së vjetër politike, dhe pret momentin të ndez një zjarr, që në vend të progresit shoqëror dhe zhvillimit ekonomik e social, të sjell regres dhe acarim ndëretnik.

Partitë politike që erdhën në pushtet, sidomos ajo që kryeson aktualisht bllokun politik maqedonas, lajtmotiv të fushatës zgjedhore patën ekonominë, investimet, uljen e papunësisë, luftën kundër korrupsionit, zbutjen e varfërisë.

Pyetja më e logjishme që shtrohet tani është:

Çka ndodhi që prej prioriteteve ekonomike, zhvillimore e sociale, Maqedonia e Veriut të rrëshqet në axhenda të dyshimta që prodhojnë tensione dhe animozitetete të natyrës ndëretnike, ku si palë më e dëmtuar dalin të jenë shqiptarët?!

Çka ndodhi që më të qenësishme për politikën e ditës, po listohen çështjet që hapin probleme të reja, siç është tendenca për degradimin e statusit politik e juridik të shqiptarëve, që filloi me shkërmoqjen e gjuhës shqipe, tendenca për pastrimin e institucioneve nga drejtuesit shqiptarë, tendenca e rikthimit të falangave maqedonase

KUSH PO E KTHEN MAQEDONINË E VERIUT
PARA MARRËVESHJES SË OHRIT?

për rrahjen e shqiptarëve nëpër rrugët e Shkupit, se sa çështjet për të cilat qytetarët kanë më shumë nevojë dhe për të cilat, fundja, kanë votuar: rroga më të dinjitetshme, çmime të përballueshme, vende të reja të punës dhe heqjen dorë nga shpërngulja për një jetë më të mirë në Perëndim?!

Tendenca politike e cila u nis si narrativë parazgjedhor që në thelb kishte sloganin “Ta kthejmë shtetin”, ka rrezik të shndërrohet në një narrativë tjetër i cili, siç po shihet, ka për synim të prodhojë një slogan tjetër “Ta mballmo shtetin vetëm për vete!”.

Në betejat identitare që patën maqedonasit me fqinjët, shqiptarët i patën jo vetëm aleat, por edhe kalorës të vijave të para të frontit. Për pasojë, shumë çështje që duhej të hapeshin në favor të avancimit të statusit juridik e kushtetues të shqiptarëve, u prolonguan dhe disi u futën nën rrogë, në favor të një procesi me karakter afirmues identitar që maqedonasit kishin nevojë ta fitojnë ndaj fqinjëve.

Dhe çka ndodhi pastaj? Pasi ajo që historikisht iu kishte ndodhur shqiptarëve – të tradhëtohen!

Aktualisht – a po ndjehen të tradhë-

tuar shqiptarët nga establishtmentit politik maqedonas pas gjithë atij kontributi që dhanë ata në zhvillimin e betejave të përbashkëta identitare me maqedonasit?

A ka një bashkërendim të heshtur, por mirë të menduar, në mes të subjekteve politike maqedonase (pushtet-opozitë) për rikthimin e proceseve politike para Marrëveshjes së Ohrit, ku shqiptarët sërish do të trajtoheshin si qytetarët të rendit të dytë, pa kurrfarë mekanizmi mbrojtës politik e kushtetues?

A ka një tendencë që Maqedonia e Veriut të rreshtohet në kuadër të një aleance të re ballkanike, përmes së cilës do të katapultohej politika e përjashtimit të vendimarrjes së shqiptarëve nga proceset e rëndësishme, sidomos tani kur Shqipëria u shkëput nga “treni” i përbashkët euro-integrues?

Këto dhe pyetje të tjera, sa më shpejt do të duhej të kenë përgjigje, sepse çdo veprim që i bën më të vonshme përgjigjet, mund të implikojë disa faktorë të tjerë destabilizues që mezi presin ta shohin Maqedoninë e Veriut sa më larg Brukselit e Washingtonit dhe sa më afër Stepave ruse.

KLODIAN TOMORRI

Në fund të vitit të kaluar, kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, deklaroi se ambicia e qeverisë së tij ishte që brenda vitit 2030, Shqipëria të tërhiqte 20 milionë turistë në vit. Pak ditë më parë, bashkëshortja e kryeministrit të Shqipërisë, zonja Linda Rama, publikoi në rrjetet sociale studimin e saj më të fundit me titull "Tregu i Punës dhe Aftësitë përballë sfidës së 20 milion turistëve." Pra, kryeministri shpall objektivat e zhvillimit të Shqipërisë, ndërsa bashkëshortja e tij i vlerëson ato.

Materiali përmbledhës i studimit niste me kryeministrin Edi Rama, kur ai vite më parë shpalli programin e Rilindjes Urbane për të nxitur turizmin, vazhdonte me lavdërimet e reformave dhe politikave të ndërmarra nga qeveria e tij gjatë këtyre 11 viteve dhe mbyllej me shkrimet e mediave ndërkombëtare, që e cilësonin Shqipërinë fanarin europian të turizmit. (Kliko këtu për materialin video të studimit të BERZH). Të gjithë të lumtur dhe të gëzuar.

Nëse zonja Rama do të vlerësonte tregun e punës dhe suksesin e politikave të qeverisë në sektorin e turizmit për llogari të bashkëshortit të saj kryeministër, që ky i fundit të kishte një zë më tepër ekspertë si input për vendimarrje, kjo nuk do të kishte asgjë të keqe. Problemi është se studimet e zonjës Rama kryhen për llogari të organizatave më të rëndësishme botërore, të cilët janë dhe zërat më prestigjiozë që vlerësojnë qeverisjen në Shqipëri.

Studimi për tregun e punës përballë sfidës së 20 milionë turistëve është kryer për llogari të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Por BERZH nuk është donatori i vetëm, i cili ja ka besuar zonjës Rama vlerësimin e reformave dhe progresit

TË NDERUAR DONATORË: A NDIHENI JU REHAT KUR SUKSESIN E REFORMAVE NË SHQIPËRI E VLERËSON BASHKËSHORTJA E KRYEMINISTRIT?



në Shqipëri. Thujse të gjitha studimet e UNDP-së në Shqipëri, po ashtu, kanë autorësinë e zonjës Rama dhe bashkëpunëtorës së saj Elena Polo. Nga vlerësimet për financat e zhvillimit e deri të analiza për pasojat e tërmetit. Organizata Botërore e Punës, po ashtu.

Studime e organizatave ndërkombëtare prestigjiozë janë inputi kryesor mbi të cilin Shqipëria vlerësohet në arenën ndërkombëtare. Pra ato janë materialet mbi të cilat BERZH,

UNDP, ILO dhe të tjerë i vënë notë progresit dhe qeverisjes në Shqipëri. Ndaj, pyetja që shtrohet natyrshëm është vetëm një; Sa të besueshme mund të jenë ato, kur kryhen nga një person i cili ndodhet në konflikt të hapur interesi?

Me apo pa vetëdije institucionet më të rëndësishme të botës kanë krijuar në Shqipëri një sistem të mbyllur, i cili tashmë po u heq shqiptarëve edhe mundësinë për t'u vlerësuar objektivisht nga ekspertë jashtë konfliktit të

interesit. Megjithatë këtu vlen të theksohet diçka shumë qartë. Bashkëshortja e kryeministrit ka të gjithë të drejtën e saj të punojë si eksperte e BERZH, UNDP, Bankës Botërore e madje edhe e Departamentit të Shtetit dhe Komisionit Europian për të vlerësuar gjendjen e ekonomisë dhe ecurinë e reformave në Kazakistan, Gjermani apo dhe Shtetet e Bashkuara. Madje kjo do të ishte dhe motiv krenarie për Shqipërinë, që arrin të prodhojë ekspertë të këtyre niveleve.

Por nëse zonja Rama e bën këtë në Shqipëri, ka një problem shumë të madh. A ndihen rehat donatorët që të flasin në Shqipëri me zërin e bashkëshortes së kryeministrit?!

UNDP dhe BERZH janë ndër dy organizatat më prestigjioze të zhvillimit në botë, të cilat asistojnë vendet në zhvillim si të luftojnë korrupsionin dhe të shmangin konfliktin e interesit. Por siç pati thënë i madhi Koço Devole dikur në një nga skeçet e tij brilante, instancat paskan rënë vetë brenda në pusin e konfliktit të interesit.

Në Rumaninë komuniste, Elena Çausheku, bashkëshortja e diktatorit rumun Nikolae Çausheku, kishte një fiksim të papërmbajtshëm për t'u bërë shkencëtare. Për këtë qëllim, i gjithë aparati shtetëror në Rumani u vu në punë, jo vetëm për ta shpallur zonjën Çausheku shkencëtare në Rumani, por edhe për ta afirmuar atë në mbarë botën.

Falë kësaj pune ajo arriti të merre edhe titullin më prestigjioz shkencor në Europë, anëtarësimin në Shoqërinë Mbretërore Britanike. Megjithatë edhe fiksimet e marra të zonjës Çausheku e kishin një kufi. Ajo kurrë nuk shkoi deri në pikën që të vlerësonte suksesin e politikave dhe reformave të bashkëshortit të saj për llogari të komunitetit ndërkombëtar.

Ndaj, nuk shkon që kjo të ndodhë sot në Shqipëri./KAPITALI

NA GJENI NA FACEBOOK KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website



AKOMA NUK KENI WEBSITE?

Akoma nuk jeni të
regjistruar ne google?

Our Best Service

- ✓ Responsive Website
- ✓ Landing Page
- ✓ Redesign Website
- ✓ Web Development

ADRESA E ZYRAVE:

➤ **30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT**



020 7018 7929



073 4066 5946



078 5997 7545

AUGUSTIN PALOKAJ

BE-JA TË MOS BJERË NË GRACKA RRETH MBËSHTETJES PUBLIKE PËR ANËTARËSIM TË VENDEVE TË REJA

Serbia është kandidatja e cila përkëdhelet më së shumti nga BE-ja, e në të cilën ka më së paku mbështetje të qytetarëve për anëtarësim në BE. Pushteti në Serbi, si dhe një pjesë e opozitës, përmes propagandës së pandërprerë kundër Perëndimit, krijojnë opinionin kundër anëtarësimit në BE. Pastaj atë opinion negativ e përdorin për trysni ndaj BE-së që të bëjë lëshime. Dhe në Bruksel menjëherë e marrin parasysh këtë duke thënë se, “nuk duhet të jemi tepër të ashpër ndaj Serbisë, sepse kjo do t’i largojë ata nga BE-ja”. Në anën tjetër, askush as nuk mendon për shqiptarët e Kosovës, të cilët në përqindjen më të madhe mbështesin anëtarësimin në BE.

Shqiptarët në rajonin e Ballkanit Perëndimor në të gjitha shtetet ku jetojnë, pa dyshim janë mbështetësit më të mëdhenj të anëtarësimit të vendeve të tyre në BE dhe janë grupi etnik me orientimin më të madh properëndimor. Mbështetja për BE-në dhe për NATO-n në mesin e shqiptarëve është aq e madhe, saqë është edhe afër anomalive në matjet e opinionit publik. Në të kaluarën, diplomatët tregonin një anekdotë me një zyrtar të Shqipërisë. Kur e kishin pyetur se “si është e mundur që mbështetja për NATO të jetë 97 për qind”, ai ishte përgjigjur se do të zhvillojnë një fushatë për të bindur edhe këta 3 për qind të tjerë. Sa i përket NATO-s, shqiptarët pak a shumë janë të kënaqur me atë që ka bërë kjo aleancë për ta. Ka ndërhyrë për të çliruar shqiptarët e Kosovës, NATO-ja është në Kosovë për të ruajtur paqen, ndërkohë që Shqipëria është bërë anëtare e NATO-s. Edhe Maqedonia e Veriut, mes tjerash, edhe falë angazhimit të madh të shqiptarëve të këtij vendi, është bërë anëtare e NATO-s. Rol të rëndësishëm shqiptarët kanë pasur edhe në krijimin e shtetit të pavarur të Malit të Zi dhe anëtarësimin në NATO. Por BE-ja nuk



ka qenë aq e drejtë dhe korrekte ndaj shqiptarëve.

Është dashur që të kalojnë më shumë se 15 vjet që nga aplikimi i Shqipërisë për anëtarësim në BE që të hapet kapitulli i parë në negociatat e anëtarësimit. Kosovën, BE-ja nuk e trajton si shtet dhe nuk e ka marrë fare në shqyrtim aplikimin e saj për anëtarësim në BE as pas dy vitesh. Me Kosovën, BE-ja mban vetëm raporte minimale formale, pa paragjykuar qëndrimin e vendeve anëtare ndaj statusit të saj. Kosova është i vetmi vend në Evropë që ka kërkuar anëtarësim në BE dhe që nuk ka statusin e vendit kandidat. Por përkundër kësaj, dëshpërimi i drejtë i shqiptarëve me BE-në nuk është përkthyer në kundërshtim të BE-së. Niveli i mbështetjes për anëtarësim në BE ka mbetur edhe sot e kësaj dite jashtëzakonisht i madh në mesin e shqiptarëve kudo që jetojnë. Bile mund të thuhet lirisht se për anë-

tarësim në BE as në vendet e tashme anëtare e as në ato candidate nuk ka mbështetje të qytetarëve më shumë sesa në Shqipëri dhe në Kosovë. Dhe kjo mbështetje është e singertë. Është shprehje e dëshirës, vullnetit dhe synimit strategjik që të bëhen pjesë e familjes Evropiane. Dhe nuk kanë asnjë orientim tjetër.

Dallimi ndoshta me popujt e tjerë në rajon është vetëm se duke qenë mbi 90 për qind pro BE-së, shqiptarët ndoshta janë për një a dy përqindje më shumë edhe pro amerikanë. Dhe në të kaluarën jo rrallë ky proamerikanizëm i shqiptarëve ka krijuar xhelozë në Bruksel. Aq sa kur Kosova u njoh nga Izraeli dhe kur si pjesë e pajtimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës hapi ambasadën në Jerusalem, BE-ja ishte aq e ashpër në reagime saqë kërcënoi se kjo “do të ketë pasoja serioze në rrugëtimin e Kosovës drejt BE-së”.

Më shumë BE-ja shqetësohej për qëndrimet proamerikane të shqiptarëve sesa për qëndrimet proruse të serbëve. Dhe kur SHBA-të vendosën që të sanksionojë Kosovën, në selinë e BE-së me ironi thoshin se “ja çka po u bëjnë miqtë tuaj amerikanë!”. Natyrisht, kur SHBA-të kritikojnë Kosovën, një herë duhet pritur që BE ta bëjë këtë tri herë. Kur BE-ja i vendosi masat ndaj Kosovës, të cilat janë akoma në fuqi, në Bruksel thoshin se “E kanë bërë këtë edhe SHBA-të, edhe Shqipëria”. Por as këto masa nuk i kanë kthyer qytetarët e Kosovës kundër BE-së. Krejt ndryshe është situata në Serbi dhe në pjesën e Bosnjë-Hercegovinës ku jeton shumica serbe. Ata janë më shumë në anën e Rusisë sesa të Perëndimit. Me këtë qëndrim të theksuar proruse të qytetarëve arsyetohet edhe refuzimi i Serbisë që të mbështesë sanksionet e BE-së ndaj Rusisë.

Duhet të jetë e kuptueshme pse serbët janë aq shumë kundër Perëndimit në përgjithësi dhe BE-së në veçanti. Sepse ata në secilin nivel politik dëgjojnë përditë akuza të rënda ndaj BE-së. Dëgjojnë se si Perëndimi është “hipokrit, sepse ka njohur Kosovën”, se “Perëndimi dëshiron destabilizimin e Serbisë” dhe shumë akuza të tjera. E vetmja temë ku flitet në mënyrë pozitive për BE-në janë investimet dhe mjetet financiare që jep BE-ja dhe vendet anëtare. Serbia është kandidatja e cila përkëdhelet më së shumti nga BE-ja e në të cilën ka më së paku mbështetje të qytetarëve për anëtarësim në BE. Pushteti në Serbi, si dhe një pjesë e opozitës, përmes propagandës së pandërprerë kundër Perëndimit, krijojnë opinionin kundër anëtarësimit në BE. Pastaj atë opinion negativ e përdorin për trysni ndaj BE-së që të bëjë lëshime. Dhe në Bruksel menjëherë e marrin parasysh këtë duke thënë se, “nuk duhet të jemi tepër të ashpër ndaj Serbisë, sepse kjo do t’i largojë ata nga BE-ja”.

Në anën tjetër, askush as nuk mendon për shqiptarët e Kosovës, të cilët në përqindjen më të madhe mbështesin anëtarësimin në BE. Por kjo mbështetje nuk po arrin t’ua zbusë zemrën atyre në BE që marrin vendime dhe Kosova vazhdon të jetë e izoluar dhe e lënë jashtë proceseve formale të integritimit në Bashkimin Evropian. Prandaj kur në BE duan që të arsyetojnë qasjen përkëdhelëse ndaj Serbisë me dëshirën që të rrisin mbështetjen e qytetarëve për anëtarësim, le ta kenë parasysh edhe mbështetjen e madhe që ekziston për BE-në në mesin e shqiptarëve në rajon, sidomos në Kosovë.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



MEHMET ELEZI

1. Meqenëse 20 tetori qëlloi e diel, pensionistët presin me e marrë sot "shtesën e pensionit". Dikush në internet e llogariste indeksimin 4 për qind me një kilogram "groshë të vjetra". Hajgare me shtesën më të pashpresë të shoqërisë.

2. Nëpër klinikat e lagjeve bëhet kontrolli "si je" ose check-up. Për të moshuarit mbi 70 vjeç, mollë e ndalueme. "Kështu kemi urdhër". Paçka se moshja e tretë është e vetmja shtesë shoqërore që i ka paguar sigurimet deri në qindarkë, pasi e ka mbyllur ciklin e punës. Dhe paçka se moshja e tretë ka nevojë më shumë se gjithkush për përkujdesje shëndetësore.

Në vend të "shëndetësisë falas", qeveria ofron vdekje me detyrim. Ua cakton shqiptarëve kufirin e jetës, para se t'ua caktojë Zoti. Ditën që mbushni shtatëdhjetë vjet, jeni të fshirë prej kësaj bote. Si kuajt e plakur, që i braktisin në pyll, ku ka pak bar e shumë ujë. Për "kuajt e plakur", që quhen shqiptarë, mjafton një ujë i gjatë: kryeqeveritari "rilindas".

3. Fëmijët pikë e pesë nëpër botë ua presin biletën, kanë mall të dy palët. Por si me udhëtue? Mbi 65 vjeç kompanitë e sigurimeve nuk bëjnë sigurim shëndetësor.

Vetëm njëra thotë po.

- Sa kushton për një muaj?

- 150 euro, jo, prit...

- Mirë. Çfarë mbulon ky sigurim?

- Sëmundjet e papritura. Sëmundjet kronike jo.

- Për shembull, nëse më kap virusi i Nilit?

- A, jo, atë jo.

- Një bronkopneumoni?

- As atë jo.

- Çfarë atëherë?

- Nëse thyen këmbën. Moshja juaj...

- Faleminderit, s'kam rrezik këmbë. Këtë sezon nuk luaj, trajneri më ka lënë në stol, me rezervat!

4. Hajgarja e katërt përsëritet dy herë në vit. Çdo mars e çdo shtator, pensionistët duhet të nënshkruajnë "deklaratën e gjallesës". Domethënë të deklarojnë se s'kanë vdekur, janë gjallë. Zvarrë-zvarrë deri në bankë me karroca, me paterica, me kokrrat e tensionit e të zemrës në xhep, me kateter (ata me prostatë të rënduar), duke u dridhur së ftohti.

- Po sikur, pasi të vdes unë, të vijë e të bëjë "deklaratën e gjallesës" një dytës, një sozi imja, e ta zhvatë pensionin?

- E pamundur. Gjithçka është në sistem, pas njoftimit për vdekjen llogaria bankare e të ndjerit bllokohet menjëherë.

- Atëherë pse na mundoni kot?

- S'e di. Ata të ISSH (Institutit i Sigurimeve) e kërkojnë.

Thonë se shejtani, kur s'ka punë, tredh ato të vetat. I tredh të vetat, por u dhemb mbi një të tretës së shqiptarëve, që kanë mbetur në Shqipëri:

rreth 700.000 pensionistë.

5. Hajgarja e pestë, cinizëm veçanërisht i hollë. I ka mbaruar të moshuarit afati i letërnjoftimit (ID), i japin letërnjoftim të vlefshëm për... 50 vjet.

Që të mos e mundojnë me ardhë prapë kur të mbushë 110, 120, 130, 140 vjet!

Hulumto sa të duash në praktikat e diktaturave fashiste e staliniste, këso talljesh cinike në bllok, me krejt moshën e tretë, nuk mund të gjes.



ROBESPIERRISTËT E VEGJËL MES NESH



GENC POLLO

Disa komente ndaj postimit tim mbi arrestimin e z. Ilir Meta mund të përmbledhen kështu: mirë ja bënë maskarait, kriminelit, hajdutit që e arrestuan ashtu si e arrestuan.

Disa mendime sërish për këtë temë:

Në postimin fillestar nuk u shpreha nëse kemi të bëjmë me fajtor apo të pafajshëm.

Parimisht sepse vlen parimi i prezumimit të pafajësisë e i dinjitetit njerëzor dhe se personalisht këtë opinion për rastin konkret mund ta formoj mbasi të njihem me aktakuzën dhe pleduajenë.

Po kështu gjykata që do të japë verdiktin. Gjithashtu, shpreha opin-

ionin se paraburgimi ishte i panevojshëm e i pabazuar në ligj dhe se arrestimet e krerëve opozitarë praktikisht forcojnë regjimin autoritar kleptokratik që aktualisht kemi.

Por nxitimi për të shprehur gëzim kur dikush dhunohet e poshtërohet publikisht e pa shkak nga Policia e Shtetit, sidomos kur viktima ka qenë dikushi, ka precedentë në histori: Kështu në Francën revolucionare të Robespierre-it turmat bërtisnin "aristokratët në litar" dhe xhelatët nuk humbnin kohë me procedura. Në Bashkimin Sovjetik po kështu me

borgjezët e kulakët; në Rajhun e Tretë me hebrenjtë dhe të tërë antinazistët; në Shqipërinë e pas 1945 me çdo element antiparti.

Në secilin nga këto raste të së shkuarës nuk kemi të bëjmë vetëm me fanatikë të frustruar e turma historike. Një pjesë e kanë bërë me përkushtim idealist dhe me besim se i shërbenin kauzës së drejtë. Distanca historike nga këto ngjarje të ndihmon të kesh qartësi morale.

Po kur pasioni politik dhe emocioni

njerëzor është i fortë ndërgjegjja qytetare zbehet dhe qartësia morale turbullohet.

Ka që thonë se arrestimi tek Casa Italia i shërben demokracisë, shtetit ligjor dhe integritet europian. Disa syresh edhe mund ta besojnë këtë. Por ata nuk janë veçse i fundmi variacion historik i turmave robespierriane.

Sikur nesër apo pasnesër, mosozot, po t'i ndodhë kështu Edi Ramës (siç i ndodhi edhe Robespierre-it) vlejnjë sërish parimet e mësipërme

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

VETON SURROI

BULETINI I KUQ I RADIO KISHNJEVIT

Rrëfimi i një personi të vet muar që duhet t'i dëftojë udhëheqjes për rusët që rrisin territoret e zvogëlojnë popullatën, për gratë e fëmijët palestinezë që fshihen në objekte që çdokush tjetër në botë, pos Izraelit, i quan shkolla, dollarit që zëvendësohet me një fshehtësirë, BE-së që beson në lutje religjioze...

1. Diku si në mjegull më del plaku i rregullt i katit të sipërm të Radio Kishnjev, të zyrës së palejuar për të gjithë pos tij dhe detyrës së veçantë për të dëgjuar lajmet e stacioneve të huaja dhe për ta përgatitur buletin e lajmeve, aso me ngjyrë të kuqe, për anëtarët e udhëheqjes së ngushtë komuniste. Plakun do ta ketë parë një shqiptaro-amerikan i mbetur në Kishnjev më shumë ditë se ç'kishte pasur dëshirë – pra më shumë se një – në atë që atij i dukej dimër i madh dhe pamundësi edhe më e madhe për t'u ngrohur në hotel, restorant apo çfarëdo vendi tjetër publik. Ndoshta do të ketë qenë ngrohtësia, ndoshta drita e ndezur në katin e sipërm të Radio Kishnjev apo rastësia e të qenit në të njëjtën kohë dhe hapësirë, por rrëfyeti i kësaj ngjarjeje e takoi plakun në detyrë dhe të gatshëm të shpjegonte se çka bënte, disa vjet pasi kishte rënë komunizmi dhe mbase disa vjet para se të vinte demokracia. Ai i tregoi rrëfimitarit – këtij shqiptaro-amerikan që, duke punuar për organizata joqeveritare, do të meritonte rrëfim më vete – se vazhdonte të bënte punën e vet. Rrëfimtari e shënoi diku, e bëri edhe tregim. Mua ma rrëfeu një ditë në Prishtinë dhe pas tridhjetë e kusur vjetësh më ra në mend në këtë mjegull, në mjegullën e rirëfimit në të cilën mbase e vetmja gjë e mbetur prej origjinalit mund të jenë plaku, Radioja dhe detyra e tij e pandërprerë nga ndryshimet.

Tash jam rrëfimtari vetë, pa leje nga autori origjinal i rrëfimit, pa nevojë që t'i mbetem besnik atij e me të drejtë që ta shpie tutje hartuesin e buletinit të kuq të Radio Kishnjev.

2. Buletini i kuq i ditës së djeshme rrëfeu se:

– Rusia vazhdoi të dërgonte ushtarë në Ukrainë. Plaku nuk po i shënon më numrat e ushtarëve të vvarë; tashmë çdokush që e lexon buletin e kuq është i mësuar se Rusia ka djem, burra dhe pleq të mjaftueshëm për të dërguar në front, jo edhe aq për të punuar e zhvilluar vendin. Në njëqind vjetët e fundit Rusia ka pasur gjithnjë e më shumë territor e gjithnjë e më pak njerëz për të jetuar në të; ekziston vendosmëria për të ecur drejt sukseseve të reja, më shumë tokë e më pak njerëz mbi të.

–Porti i Odesës do të vazhdojë të jetë i mbyllur. Moldavia nuk ka det, por Odesa është porti i saj. Moldavia



mund të mos ketë det, por nuk mund të mos mbetet pa port, sepse atëherë asgjë nuk është më siç ka qenë. Pra, as shteti që nuk ka det por llogarit se ka port.

–Izraeli vazhdoi të bombardonte fëmijët e gratë palestineze në Gazë, ata fëmijë dhe gra që morën guxim të fshihen në shkolla, që, siç dihet, në ecurinë e deritanishme të luftës janë objekte ushtarake. Dhe Izraeli vazhdoi të ndalonte hyrjen e ndihmave humanitare për popullsinë palestineze në Gazën veriore. Banorëve të Gazës veriore që kanë mbetur pa ushqim, pa ujë dhe pa ndihmë mjekësore, ushtria izraelite u tha që të shkonin në Gazën jugore, aty ku është e ndaluar hyrja e ndihmës humanitare. Banorëve të Gazës jugore ushtria izraelite u tha që të lëviznin drejt Gazës qendrore, aty ku ndihma humanitare nuk u lejua të hynte.

3. Buletini vazhdon

edhe me këto storie:

–Mbahet Samiti i radhës së BRICS. Kina dhe Rusia, nismëtare të kësaj organizate, rishprehën parimin bazë të kësaj organizate, atë të demokracisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Irani rikonfirmoi mbështetjen për demokraci në botë. Në Samit, pos këtyre tri shteteve ihtarë të demokracisë, marrin pjesë edhe shtetet ku ka zgjedhje të lira parlamentare, si India, Afrika e Jugut dhe Brazili.

–Sivjet është 80-vjetori i vendosjes së sistemit monetar global Bretton Woods me FMNnë, Bankën Botërore dhe dollarin si valutë shtyllë në tregti botërore. BRICS-i do të propozojë një kriptovalutë për 80 vjetët e ardhshëm. Fjala kripto rrjedh prej “kryptos”, që do të thotë e fshehtë; valutë e fshehtë dhe sistem monetar transparent duke u përpjekur të shkojnë së bashku.

–Moldavia pati referendum për futjen

e integritit në BE si kategori kushtetuese. Gjysma e vendit votoi kundër. Votat “për” të gjysmës tjetër u siguruan në fund nga diaspora.

–Bashkimi Evropian u ka hapur negociatën anëtarësimi Ukrainës dhe Moldavisë, shtetet që nuk e kontrollojnë tërësinë e territorit të vet, për më tepër njëri shtet është në luftë. BE-ja i ka dhënë status kandidati Bosnjë-Hercegovinës, një shteti që funksionon në bazë të një marrëveshjeje armëpushimi. Prejse i ka ofruar Serbisë shpejtësi integritimi në BE, numri i banorëve, të cilët duan që Serbia të hyjë në BE, ka rënë prej gati 70 për qind nën 40 për qind. BE-ja vazhdon me bindjen se, nëse çdokush përsërit publikisht se që të gjithë do të jetojnë në Evropën e bashkuar, këto do të shndërrohen në lutje, e çdo lutje, siç tregojnë religjionet, dëgjohet nga Zoti.

–Qytetarët që më së shumti duan të jenë në BE janë ata të Kosovës. Aq

kanë dëshirë për BE dhe BE-ja ka dëshirë për ta, sa brenda njëzet vjetësh mund të ketë më shumë qytetarë të Kosovës në BE se në Kosovë.

–Në SHBA anketat tregojnë se gjysma e votuesve do t'ia japin votën kandidatit që beson se imigrantët haitianë kanë meny të preferuar qentë dhe macet e bashkëqytetarëve të tyre në Springfield, Ohio.

4. Hartuesi i Buletinit të kuq në Kishnjev doli në punë çdo ditë. Kishte bindjen, atëherë kur ra komunizmi, se do të kalonte edhe një kohë e gjatë derisa të vendosej një sistem tjetër stabil, në botë e Moldavi, që do ta zëvendësonte atë që kishte jetuar deri atëherë.

Kur e mbylli Buletinin e mbrëmshëm kishte një lloj kënaqësie të papërcaktuar në shije që jo vetëm se kishte pasur të drejtë, porse do të ketë punë për një kohë të konsiderueshme.



**CHASE LODGE
DENTAL**
Clinical excellence in a relaxed space

Dental Services:

- Kontrolle Rutine ✓
- Trajtime Parandaluese ✓
- Mbushje ✓
- Stomatologji Estetike ✓
- Rehabilitim I Gojes ✓
- Trajtime Ortodontike ✓
- Kirurgji Orale ✓
- Perkujdesje Emergjente Dentale ✓

REZERVO TANI



**CHASE LODGE
HOSPITAL**
Clinical excellence in a relaxed space

Sherbimet e Ofruara:

- Pediatri ✓
- Mjek ORL ✓
- Kardiologji ✓
- Neurologji ✓
- Gjinekologji ✓
- Dermatologji ✓
- Nderhyrje Estetike ✓
- Mjek I Pergjithshem ✓
- Paketa Check Up ✓
- Mjek Psikiater & Psikolog ✓



Chase Lodge Hospital
Partneritet per nje familje te shendeteshme

Informacione Kontakti:
Telefononi Tani: 020 8358 7100

✉ info@chaselodgehospital.com
🌐 chaselodgehospital.com

PAVARËSISHT MARRËVESHJEVE, SHQIPTARËVE NË JUG TË SERBISË NUK U NJIHEN DIPLOMAT E KOSOVËS

Marrëveshja e re e nënshkruar në samitin e Procesit të Berlinit parasheh bashkëpunim më të mirë rajonal dhe mobilitet më të madh të studentëve në Ballkanin Perëndimor, por qytetarët e nacionalitetit shqiptar në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në Serbi përballen me probleme të vjetra.

Atyre nuk u njihen ende diplomat e marra në Kosovë, përkundër marrëveshjeve të mëparshme, përfshirë një në vitin 2022, e cila ka të bëjë me njohjen reciproke të diplomave universitare.

Kjo paraqet pengesë për punësimin në Serbi, ndaj të rinjtë shpesh largohen nga ky vend.

“I kam humbur të gjitha shpresat se do ta zyrtarizoj në Serbi diplomën universitare që kam marrë në Prishtinë dhe do të punësohem me të në Preshevë ose Bujanoc”, thotë një 30-vjeçare për Radion Evropa e Lirë.

“Unë kam vendosur – do të shkoj të vëllai im në Zvicër, ku derisa të gjej punë, do të kujdesem për fëmijët e tij”, thotë ajo, duke u shprehur e zhgënjyer me të gjithë politikanët në Serbi, Kosovë dhe Evropë, të cilët, siç thotë, “e kanë fajin” për problemin e mosnjohjes së diplomave.

Ajo nuk do që të identifikohet, për të mos krijuar, siç thotë, probleme shtesë për veten dhe familjen e saj.

Kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor – Kosovës, Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës – nënshkruan Marrëveshjen për qasje në arsimin e lartë dhe pranimin në studime në Ballkanin Perëndimor, në samitin e Procesit të Berlinit më 14 tetor.

Kjo është një marrëveshje e re, qëllimi i së cilës është ta rrisë lëvizshmërinë e studentëve dhe t’u japë atyre të drejtën për të studiuar në institucionet e arsimit të lartë, të akredituara në rajon.

Në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, qytetarët e nacionalitetit shqiptar presin ende që Serbia të nisë me njohjen e diplomave të marra në fakultetet në Kosovë – gjë që është dashur të zgjidhej qysh pas samitit të Berlinit në vitin 2022.

Mes tjerash, atëkohë, është nënshkruar edhe Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave universitare, të cilën autoritetet arsimore në Serbi nuk e zbatojnë kur bëhet fjalë për diplomat e marra në universitetet në Kosovë.

Për Serbinë, i diskutueshëm është termi “Republika e Kosovës” në diploma.

Asnjë nga bashkëbiseduesit e Radios Evropa e Lirë nuk mund të japë as të dhëna të përafërta për numrin e të rinjve nga jugu i Serbisë, të cilët presin



që diplomat e tyre të marra në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, të certifikohen në Serbi, por vlerësimet e tyre janë se ky problem prek deri në disa qindra njerëz.

Nga viti 2008 e deri më sot, parti dhe grupe të ndryshme politike shqiptare, organizata nga sektori joqeveritar dhe Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve kanë ndërmarrë herë pas here iniciativa dhe aksione për anulimin e vendimit për mosnjohjen e diplomave nga Kosova, por asgjë nuk e ka ndryshuar qëndrimin e Beogradit zyrtar.

Një protestë e tillë, e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve, është mbajtur më 12 gusht të këtij viti në Bujanoc, ku problemi i diplomave të panjohura është cilësuar si një formë e diskriminimit ndaj shqiptarëve në jug të Serbisë.

Barrierat administrative

Në anketën e Qendrës për Hulumtim dhe Monitorim (CZIM) nga Presheva, të realizuar në shtator në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në lidhje me përvojat personale të diskriminimit, të anketuarit nën moshën 30-vjeçare kanë përmendur më së shumti këtë problem – mosnjohjen e diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore të Kosovës.

Kujtim Sadriu, drejtor i kësaj qendre, thotë për Radion Evropa e Lirë se pas dy marrëveshjeve që kanë të bëjnë me njohjen e diplomave dhe lëvizshmërinë më të madhe të studentëve, të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit, ai nuk sheh asnjë arsye që “Beogradi t’i keqtrajtojë dhe diskriminojë shtetasit e tij shqiptarë, për fak-

tin se diplomat e tyre kanë mbishkrimin Republika e Kosovës”.

“Nëse autoritetet në Serbi nuk i shqetësojnë më dokumentet personale dhe automjetet me tabela të regjistrimit të Republikës së Kosovës, pse i shqetëson një diplomë nga Kosova, për të cilën një person i zakonshëm, një qytetar i Serbisë, është përpjekur për tre, katër apo më shumë vjet? Pa diplomë të njohur, ai detyrohet të shkojë jashtë vendit me biletë njëdrejtimëshe”, thotë Sadriu, duke shtuar se “pa ekspertë, nuk ka përparim në shoqëri”.

“Këtu duhen mjekë, inxhinierë, ekonomistë, juristë... dhe shteti duhet të luftojë për secilin prej tyre, e jo, me masat e veta, t’i detyrojë të dalin jashtë vendit. Pikërisht kjo po ndodh këtu. Pa diploma nuk ka punësim dhe pa punë nuk ka kushte jetese”, thotë Sadriu.

Ai i bën thirrje Agjencisë së Kualifikimeve të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, e cila zbaton procedurat për nostrifikimin e diplomave, që menjëherë t’i qaset certifikimit të të gjitha diplomave të marra në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

“Ne si qytetarë të Republikës së Serbisë me kombësi shqiptare nuk kërkojmë mëshirë, por kërkojmë që autoritetet shtetërore të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe obligimet e pranuar ndërkombëtarisht, të cilat na garantojnë barazi në çdo kuptim të jetës”, thotë Sadriu.

Diplomë për punë në Gjermani

Nevzad Lutfiu, kryetar i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve, thotë për Radion Evropa e Lirë se më shumë se dhjetë gjenerata të të rinjve shqiptarë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja përballen me problemin e mosnjohjes së diplomave të Kosovës dhe numri i saktë i tyre është vështirë të përcaktohet.

“Të rinjtë tanë masivisht studiojnë në Kosovë, sepse është më afër. Atje, studimet janë shumë më lirë se në Shqipëri apo në Maqedoni të Veriut, kështu që mosnjohja e diplomave ndikon shumë keq tek ata, sepse duhet të emigrojnë. Me ato diploma, punësohen shumë lehtë në Gjermani – njërin nga vendet më të pasura – por jo në Serbi”, thotë Lutfiu.

Sipas tij, pa diploma të certifikuar, të rinjtë e arsimuar nuk mund të punësohen në institucionet shtetërore, në institucionet dhe ndërmarrjet publike, e madje as në sektorin publik në nivel lokal.

Ai thotë se ky është një lloj diskriminimi, të cilin komuniteti shqiptar e ka vënë në dukje prej vitësh, dhe kërkon që Beogradi ta zgjidhë këtë problem.

“Mbrojmë interesat e Serbisë”

Ministria e Arsimit e Serbisë nuk iu përgjigj pyetjeve me shkrim të Radios Evropa e Lirë, në lidhje me zgjidhjen e problemit të nostrifikimit të diplomave nga Kosova.

Drejtori i Agjencisë për Kualifikime, Çaslav Mitroviq, thotë se diplomat e Kosovës nuk mund të njihen, sepse Serbia nuk e njeh pavarësinë e

Kosovës.

Por, shton se diplomat nga periudha e administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me vulën e OKB-së, njihen si të vlefshme në Serbi.

“Dokumentet e tilla trajtohen si vendore”, thotë Mitroviq.

Diplomat nga Shkupi dhe Tirana nuk kontestohen

Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës thekson se mosnjohja e diplomave universitare të marra në Kosovë, nuk shënjestron në mënyrë selektive pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare në jug të Serbisë, sepse, nëse do të ishte kështu, atëherë diplomat nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në Maqedoni të Veriut nuk do të njiheshin.

Sipas të dhënave që disponon ky trup, nga viti 2018 e deri më sot janë certifikuar rreth 200 diploma nga Universiteti i Tiranës dhe rreth 550 diploma nga fakultete në Maqedoninë e Veriut.

Nenad Mitroviq, drejtor i Trupit Koordinues, thotë se kontestohen vetëm ato diploma që mbajnë shenjat e Republikës së Kosovës.

“Diplomat që nuk e kanë vulën e UNMIK-ut, janë të dyshimta dhe nuk certifikohen, sepse në to është emri i së ashtuquajturës Republikë e Kosovës. Por, në pyetje është edhe çështja e cilësisë së mësimdhënies në ato institucione të arsimit të lartë”, thotë Mitroviq për Radion Evropa e Lirë.

Mitroviq shton se në vitin 2011, në Bujanoc është hapur dega e Fakultetit Ekonomik nga Subotica, për t’u mundësuar, siç thotë, studentëve të studiojnë në qytetin ku jetojnë, por, vit pas viti, numri i studentëve të regjistruar nga nacionaliteti shqiptar është duke u zvogëluar, sipas tij.

Mitroviq thotë se partitë shqiptare, herë pas here, e ngrenë këtë çështje varësisht nga nevojat politike.


“Mendoj se synim i tyre është që ta përdorin si çështje politike – gjë që sigurisht se nuk është e mirë, sepse çdo ngritje e temave të tilla për qëllime politike, mund t’i rrisë tensionet”, thotë Mitroviq.

Sipas tij, është e nevojshme që të punohet me këmbëngulje dhe durim, për të gjetur një mënyrë për tejkalimin e këtij problemi.

(Radio Evropa e Lirë)



Dotech
website



**A JENI
REGJISTRUAR
NË GOOGLE?**

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Ne mund t'iu ndihmojme edhe me:

-Business Cards

-Logos

-Banners

-Posters

-Flyers

-Video Marketing

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona

CONTACT US

Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London E13 8HT